



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 183, datë 09.04.2024

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR PERIUdhËN
2020 - 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2020-2022”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për periudhën 2020-2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e Gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së Gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e Gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, Gjyqtari referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “*Procedura*”, në të cilën përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes.

Kështu pra, në çështjet me natyrë penale (seancë paraprake me objekt dërgim në gjyq apo kërkesë për pushim; gjykim themeli), Gjyqtari si rregull përshkruan ecurinë procedurale të

çështjes penale, konkretisht datën e regjistrimit të procedimit penal, vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake (nëse është gjykim në themel), faktin se çështja i përket juridiksionit gjyqësor dhe bie në kompetencën lëndore të Gjyqtarit; faktin se Gjyqtari nuk ka shkaqe përjashtimi; faktin nëse çështja është shqyrtuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar pasi është vlerësuar se mund të zgjidhej në gjendjen në të cilën ndodhen aktet,¹ si dhe faktin se është zhvilluar gjykimi me dyer të mbyllura për shkak të pandemisë së COVID 19.² Po ashtu, sqarohet se gjykimi në seancë paraprake është zhvilluar me ose pa praninë e mbrojtësit të të pandehurit.³ Në disa raste, faktet me natyrë procedurale të tilla si prania ose jo e palës kallëzuese apo natyra e gjykimit (me dyer të mbyllura)⁴, trajtohen në rubrikën “Vlerësimi i Gjykatës”.

Në vendimet civile, Gjyqtari përshkruan ecurinë procedurale të çështjes sipas nevojës për sqarime për palët ndërgjyqëse, konkretisht në një vendim me objekt: “Njohjen e së drejtës së pronësisë”, shpjegon procedurën civile të ndjekur në rastin konkret, për efekt të situatës së krijuar prej pandemisë së COVID 19, duke cituar⁵ të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rregullimin e veprimtarisë gjyqësore⁶. Një çështje tjetër civile, të diktuar nga disponimi me vendim jopërfundimtar, Gjyqtari përshkruan ecurinë procedurale të çështjes civile në veprime paraprake dhe në seancë pajtimi, duke sqaruar në vendim se pala paditëse u njoftua në adresën e vendqëndrimit të përcaktuar prej saj dhe njoftimi u kthye se banon në adresë tjetër. Më tej, gjykata ka njoftuar në adresën e banesës bashkëshortore dhe dëftesa e komunikimit u kthye me shënimin “Personi refuzon marrjen” për paditësin dhe me shënimin “Personi banon jashtë shtetit” për të paditurin. Në vendim, Gjyqtari sqaron se në kushtet kur paditësja nuk ka pengesë ligjore të marrë pjesë në seancë pajtimi, çështja civile duhet të pushohet.⁷ Në disa raste, konkretisht në çështjet civile me objekt: “Zgjidhje martesë”, faktet procedurale që lidhen me realizimin e seancës së pajtimit sipas nenit 134 të Kodit të Familjes⁸; pezullimin e çështjes kur nuk krijohet bindja se nuk

¹ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

² Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³ Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴ Vendim nr. 99, datë 20.05.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 49, datë 20.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵ Konkretisht, në vendim Gjyqtari citon: nenin 3, pika 4, nënpika ç) të Aktit Normativ me Fuqinë e Ligjit Nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” (miratuar me ligjin nr. 30/2020, ndryshuar me ANF nr. 21, datë 27.05.2020), për shkak të pandemisë COVID-19.; Vendimet nr. 127, datë 10.03.2020; nr. 128, datë 23.03.2020; nr. 133, datë 06.04.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë.”; Vendim i Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, gjendje kjo e zgjatur deri në datën 24.06.2020 me Vendimin nr. 18/2020 të Kuvendit të Shqipërisë (botuar në Fletorez Zyrtarë Nr. 73, datë 24.04.2020), si dhe Aktit Normativ me Fuqinë e Ligjit Nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”; Akti Normativ me Fuqinë e Ligjit nr. 21, datë 27.05.2020, për rifillimin e proceseve gjyqësore për të gjitha llojet e mosmarrëveshjeve.

⁶ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷ Vendim nr.155, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸ Vendim nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ; Vendim nr. 193, datë 27.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 18, datë 27.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

mund të arrihet pajtimi midis bashkëshortëve, konform nenit 136 të Kodit të Familjes⁹; shtjellohen dhe analizohen në rubrikën “*Vlerësim i Gjykatës*”. Në rubrikën “*Vlerësim i Gjykatës*” gjejmë të trajtuar gjithashtu në një vendim civil¹⁰ me objekt: “*Njohjen e së drejtës së pronësisë*” të efekteve të akteve ligjore e nënligjore të dala si pasojë e pandemisë së COVID 19 në veprimtarinë gjyqësore. Ndërsa, në një çështje civile¹¹ me objekt: “*Marrëdhënie pune*”, si dhe në një tjetër çështje¹² me objekt: “*Njohje e së drejtës së pronësisë*”, faktet me natyrë procedurale janë objekt trajtimi në rubrikën “*Rrethanat e faktit*”, konkretisht ato që lidhen me marrjen e vendimeve të ndërmjetme nga Gjykata në veprime paraprake dhe në seancë përgatitore, të cilat lidhen me plotësimin e të metave sipas nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile; marrjen e provave shkresore kryesisht bazuar në nenin 167 të Kodit të Procedurës Civile; marrjen e provës me ekspert sipas nenit 224 të Kodit të Procedurës Civile; thirrjen e personave të tretë sipas nenit 191 të Kodit të Procedurës Civile; si dhe pakësimin e objektit të padisë në bazë të neneve 2, 6, 185, 200, 201 të Kodit të Procedurës Civile.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, është shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë. Posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, efektet e pandemisë së COVID 19, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural (në vendimet që bën përshkrim dhe analizë të rrethanave me karakter procedural), Gjyqtari parashton rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje përgjithësisht të titulluar “*Rrethanat e faktit*”, duke i sqaruar ato në mënyrë të qartë, në një rend kronologjik dhe logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat Gjyqtari ka konkluduar lidhur me provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me paraqitjen dhe analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të Gjyqtarit lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes.

- Në çështjet me objekt: “*Zgjidhje martese*” Gjyqtari përshkruan rrethanat e faktit në mënyrë kronologjike duke sqaruar datën kur është lidhur martesa, faktin se nga martesa kanë lindur fëmijë, faktin se cili është shkaku i kërkesës për zgjidhje martese, duke integruar provat, prej të cilave rezultojnë ato në mënyrë të detajuar, si dhe pretendimet e qëndrimet e palëve të shprehura në seancë pajtimi, gjatë gjykimit dhe bisedime përfundimtare.
- Në vendimet penale me objekt: “*Gjykimin e çështjes penale*”, “*Dërgim në gjyq*” dhe “*Vleftësim arresti, caktim mase*”, Gjyqtari pasqyron rrethanat e çështjes në mënyrë kronologjike duke

⁹ Vendim nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹¹ Vendim nr. 175, datë 02.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹² Vendim nr. 193, datë 24.05.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

përshkruar datën, orën, vendin mënyrën se si ka ndodhur fakti penal bazuar në veprimet hetimore të kryera dhe veprimet e organit procedues (*këqyrja e vendit të ngjarjes, akt ekspertimi biokimik, akt ekspertimi teknik balistik, sekuestrimi i provave materiale, akt ekspertimi kimik, akt ekspertimi teknik, pyetja e personave që kanë dijeni¹³, kopje të deklaratave doganore; ekspertim teknik – grafik; dëshmia¹⁴; këqyrje e vendit të ngjarjes, pyetja e personave që kanë dijeni, informacion nga institucionet kompetente¹⁵; procesverbal këqyrje të vendit të ngjarjes, procesverbal për verifikimin e deklaratimeve, akt ekspertimi, procesverbal sekuestrimi¹⁶), duke përshkruar provat nga të cilat burojnë faktet objekt akuze, dhe që përmbajnë llojin e aktit procedural, datën, numrin përkatës dhe përpiluesi.*

- Në vendimet penale me objekt: *“Pushim procedimi”*. Gjyqtari përshkruan rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga të gjitha veprimet e mundshme hetimore të kryera: *këqyrje e vendit të ngjarjes, këqyrje e automjetit, ekspertim mjekoligjor të viktimës, ekspertim auto teknik të automjetit, pyetjen e personave që kanë dijeni për veprën penale, këqyrjen fizike të shoqëruar me fotografi të viktimës dhe pyetjen e personit nën hetim¹⁷; këqyrje e vendit të ngjarjes, pyetjen e personave që kanë dijeni për veprën penale, aktin e ekspertimit vlerësues për sendet e vjedhura¹⁸.*

- Në çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare, Gjyqtari përshkruan rrethanat e çështjes të rezultuara nga provat e lejuara për shqyrtim dhe të administruara në gjykim, sipas rendit kronologjik historik të veprimeve të kryera nga secila palë për realizimin e të drejtave të saj.¹⁹

- Në çështjet civile familjare me palë kundërshtare, kryesisht me objekt: *« Zgjidhje martesë »*, Gjyqtari përshkruan rrethanat e faktit në mënyrë kronologjike duke sqaruar datën kur është lidhur martesa, faktin se pala e paditur me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin, si dhe faktin se nga martesa nuk kanë lindur fëmijë. Rrethanat e faktit rezultojnë të përshkruara të mbështetura nga aktet provuese të cituara qartësisht në vendim²⁰.

- Në një çështje civile familjare me palë kundërshtare, me objekt: *“Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes”*, Gjyqtari përshkruan rrethanat e faktit në mënyrë kronologjike siç kanë rezultuar nga provat. Rrethanat rezultojnë të përshkruara dhe integruara gjithashtu në pjesën e vlerësimit të gjykatës, paralelisht me analizimin e secilit kriter ligjor, dhe të rezultuar nga provat e lejuara për shqyrtim dhe rrethanat e tjera të konstatuara si pasojë e natyrës së procesit gjyqësor.²¹

- Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes

¹³ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁴ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁵ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 81, datë 16.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

¹⁶ Vendim nr. 38, datë 15.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁷ Vendim nr. 127, datë 09.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁸ Vendim nr. 99, datë 20.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁹ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁰ Vendim nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Vendim nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 18, datë 27.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 27.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²¹ Vendim nr. 28, datë 13.10.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, Gjyqtari krijon idenë e tij rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtari, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*njohjen e së drejtës së pronësisë; detyrimin e të paditurve të më paguajnë dëmshpërblimin për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës; kundërshtim i veprimeve përmbartimore; Detyrimin e të paditurve që të na njohin të drejtën e rimbursimit për blerjen e karburanteve; lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e kredisë, pavlefshmëri titulli ekzekutiv*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj; lëshimi i urdhërit të mbrojtjes*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal (*“Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal; “Vrasjes nga pakujdesia”, “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë“ e kryer dy herë, “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” të parashikuar nga nenet 85, 278/1, 280 dhe 301 i Kodit Penal.; “Dhuna në familje “dhe “Keqtrajtimit të të miturit” të parashikuar nga nenet 130/a/4 dhe 124/b/1 të Kodit Penal; “Plagosje e lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal; “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal; “Vjedhje e mbetur në tentativë” parashikuar nga neni 134/1 e 22 i Kodit Penal; “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i K. Penal; “Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik” “Vjedhje” dhe “Dhunë në familje” parashikuar nga nenet 242, 134, 130/a/1 të Kodit Penal; “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor“ parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal; “Vjedhje“ parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.)*

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e Gjyqtarit, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se Gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, Gjyqtari identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 36, 41 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore të gjykatave; nenin 45 Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën tokësore ekskluzive të saj²²;
- nenet 2, 6, 185, 200, 201; 12, 14, 16, të Kodit të Procedurës Civile lidhur me parimin e disponibilitetit të padisë, barrën e provës që ka pala që pretendon një fakt, zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor, kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm²³;
- nenet 224, 230 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me marrjen e provës me ekspert²⁴, marrjen e provës me dëshmitar²⁵; neni 151 Kodit të Procedurës Civile lidhur me kërkesën për rivendosje në afat.²⁶
- nenin 191 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me thirrjen e personit të tretë²⁷;
- nenin 32 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me rastet e ngritjes së padisë²⁸;
- nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me vërtetimin gjyqësisht të faktit juridik²⁹;
- neni 106 Kodit të Procedurës Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore³⁰.
- nenin 167 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me marrjen e informacionit pranë institucionit kompetent; nenin 251 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me formën jo të duhur procedurale (fotokopje) të shkresave³¹;
- nenet 42, 47 të Kodit të Procedurës Civile dhe neni 7 i Kodit të Punës lidhur me kompetencën tokësore të mosmarrëveshjeve të punës në lidhje me nenin 54 të Kodit të Procedurës Civile mbi të drejtën e zgjedhjes së padisë³²;
- nenet 36 dhe 41 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore; nenin 51 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën tokësore në çështjet me objekt “Zgjidhje martesë”³³, nenin 136 të Kodit të Familjes lidhur me pezullimin e çështjes së zgjidhjes së martesës kur Gjykata çmon se ka mundësi pajtimi midis tyre³⁴.

²² Vendim nr. 368, datë 27.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 28, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²³ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 28, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr.155, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁴ Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

²⁵ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁶ Po aty.

²⁷ Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

²⁸ Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr.136, datë 07.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

²⁹ Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁰ Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

³¹ Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³² Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³³ Vendim nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;Vendim nr. 18, datë 27.01.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 27.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁴ Vendim nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- nenet 154 510, 511, të Kodit të Procedurës Civile lidhur me të drejtën e padisë, titullin ekzekutiv, dhe urdhërin e ekzekutimit³⁵.
- nenin 41 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën lëndore; nenet 45 dhe 46 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën lëndore, funksionale dhe ekskluzive; nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me verifikimin kryesisht nga Gjykata të kompetencës lëndore³⁶;
- nenin 158/a në harmoni me nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me marrjen e vendimit të ndërmjetëm për thirrjen e personit të tretë në veprime paraprake³⁷;
- nenin 176 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me verifikimin e paraqitjes së palëve në proces³⁸;
- nenin 179 të K.Pr.Civile lidhur me pasojat e mospjesëmarrjes së palëve në gjykim³⁹;
- nenin 135/1 të Kodit të Familjes lidhur me mosparaqitjen e paditësit në seancë pajtimi⁴⁰;
- nenin 130 paragrafi i gjashtë i Kodit të Procedurës Civile lidhur me njoftimet kur refuzohet marrja dijani⁴¹.
- nenin 125 të Kodit Civil lidhur me mosinvestimin kryesisht të gjykatës sa i përket parashkrimit të padisë⁴²;
- nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me detyrimin për të bërë kallëzim penal në kuadër të veprimtarisë tregtare dhe mbrojtjes së interesat publik kur konstatohen raste të rilidhjes së energjisë elektrike nga persona të paautorizuar për të kryer një veprim të tillë⁴³;
- neni 186 i Kodit të Procedurës Civile lidhur me kërkesën për marrjen e provës nëpërmjet gjykatës⁴⁴.

Gjithashtu, Gjyqtari identifikon dispozitat proceduralë civile me natyrë materiale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në themel: nenet 517, 518, 519 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me lajmërimin për ekzekutim vullnetar, përmbajtjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm; nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile si një mjet juridik i pavarur që ngrihet në formën e padisë dhe jo si një kërkesë gjatë gjykimit të një ankimi për kundërshtim veprimesh përmbartimore⁴⁵.

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*seancës paraprake, gjykim themeli apo kërkesë penale në fazën e hetimit*), apo ritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), Gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

³⁵ Vendim nr. 9, datë 19.01.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

³⁶ Vendim nr.136, datë 07.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁷ Vendim nr. 28, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁸ Vendim nr.155, datë 20.04.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Vendim nr. 166, datë 15.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- nenin 4/2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm; nenet 69, 74, 75 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore; nenin 13 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me përbërjen e trupit gjykues; nenet 15-18 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me mungesën e shkaqeve të përjashtimit; nenin 151 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me çmuarjen e provave; nenet 403 -406 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me institutin e gjykimit të shkurtuar; nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me shpenzimet gjyqësore; nenin 190/b të Kodit të Procedurës Penale lidhur me disponimin për provat materiale⁴⁶; nenin 166 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me vlerën e pyetjes së të pandehurit⁴⁷; nenin 367 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me thirrjen dhe ballafaqimin e dëshmitarëve; nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me nenin 306 të Kodit Penal sa i përket detyrimit për të bërë kallëzim penal për veprën penale të “Dëshmisë së rreme”⁴⁸;
- nenin 332/b të Kodit të Procedurës Penale lidhur me zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura; nenin 332/dh të Kodit të Procedurës Penale lidhur me përbërjen e trupit gjykues; 332/a -332/gj të Kodit të Procedurës Penale lidhur me seancën paraprake; nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me pushimin e gjykimit; nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës; nenet 228, 244 e vijues të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kërkesën për caktim mase sigurimi personal; nenin 329 paragrafi i katërt dhe nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me pamundësinë e gjykatës për të urdhëruar prokurorin të formulojë akuzë për një person, emri i të cilit nuk është i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale; nenin 388 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me deklarimin të pafajshëm të të pandehurit⁴⁹;
- nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kompetencën tokësore; nenet 27/2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, nenin 81 të Kodit të Procedurës Penale dhe Vendimit nr. 79 datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur” lidhur me kompetencën e gjyqtarit si gjyqtar i seksionit për të mitur; nenet 403 -406 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me institutin e gjykimit të shkurtuar; nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me shpenzimet gjyqësore; Aktin Normativ me fuqinë e ligjit Nr. 9 datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID 19” në harmoni me nenin 39 pika 3 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur lidhur me zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura në kushtet kur një prej viktimave është e mitur⁵⁰.

⁴⁶ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁷ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁸ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁹ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 177, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 49, datë 20.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 81, datë 16.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁰ Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- nenet 58 e 59 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ndjekjen me ankim të drejtpërdrejte në gjykatë të akuzave penale private nga viktimat akuzuese⁵¹;
- nenin 350 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me pasojat e mosparaqitjes së mbrojtësit⁵²;
- nenin 34/a dhe 34/b të Kodit të Procedurës Penale lidhur me njohjen e letrës së të drejtave nga i pandehuri në hetime paraprake; nenet 151 paragrafi 3 dhe neni 128/a i Kodit të Procedurës Penale lidhur me mungesën e pavlefshmërisë së akteve dhe papërdorshmëri të provave; nenet 400-406 të K.Pr.Penale lidhur me llojet e gjykimeve të posaçme; nenin 332/ë të Kodit të Procedurës Penale lidhur me përmbajtjen e fashikullit të gjykimit; nenin 332/g të Kodit të Procedurës Penale lidhur me aktet që nuk përfshihen në fashikullin e gjykimit t'i kthehen prokurorit; nenin 332/dh të Kodit të Procedurës Penale lidhur me pavarësinë e vendimmarrjes midis gjyqtarit të themelit dhe atij të seancës paraprake.⁵³
- nenet 228, 229, 230, 251/1, 252 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, kushtet dhe kriteret për arrestimin në flagrancë dhe flagrancë; neni 244 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Penale lidhur me moscaktimin e një mase sigurimi më të rëndë sesa ajo e kërkuar nga Prokurori⁵⁴.
- nenet 27/2 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, nenin 81 të Kodit të Procedurës Penale dhe Vendimit nr. 79 datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur” lidhur me kompetencën e gjyqtarit si gjyqtar i seksionit për të mitur⁵⁵;
- nenin 329/a i Kodit të Procedurës Penale lidhur me vendimmarrjen e gjyqtarit të seancë paraprake për kthimin e akteve prokurorit; neni 287 të Kodit të Procedurës Penale lidhur shënimin e emrit në regjistrin e veprave penale; nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ndjekjen me ankim të figurës së veprës penale të parashikuar nga paragrafi i parë i neni 290 të Kodit të Procedurës Penale⁵⁶;
- nenin 261/1 pika a të Kodit të Procedurës Penale mbi shuarjen e masës së sigurimit personal⁵⁷.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se Gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, i cili gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori: (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

Në vendimet civile me objekt: “*Detyrimin e njohjes pronar; Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj; Marrëdhënie pune; Kundërshtim veprimesh përmbartimore; Lëshim urdhëri mbrojtje; Shpërblim dëmi, Pavlefshmëri titulli ekzekutiv,*

⁵¹ Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵² Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵³ Vendim nr. 177, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 49, datë 20.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 81, datë 16.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁴ Vendim nr. 38, datë 15.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁵ Vendim nr. 127, datë 09.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁶ Vendim nr. 127, datë 09.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 99, datë 20.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁷ Vendim nr. 127, datë 09.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

etj.”, Gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, konkretisht:

Në paditë civile me objekt: *“Njohjen e së drejtës së pronësisë”*⁵⁸, Gjyqtari identifikon nenin 163 të Kodit Civil lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë; Ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronave dhe përfundimin e procesit të kompesimit”; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 222 datë 23.03.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës”; Ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”; Ligji nr. 7698/1993 “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve”; Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; Ligji nr. 111/2018 “Për Agjensinë Shtetërore të Kadastrës”; Ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”; Ligji nr. 108 datë 29.08.1945 “Për reformën agrare, shpronësimet kundrejt një shpërblimi të drejtë, sipas përcaktimeve të kohës dhe pronat që i janë dhuruar shtetit”; Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Në padinë civile me objekt: *“1. Detyrimin e të paditurve të më paguajnë dëmshpërblimin për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës”*⁵⁹, Gjyqtari identifikon nenin 2 të Kodit të Punës lidhur me standartet e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare; nenin 12 të Kodit të Punës lidhur me kontratën e punës; nenin 140 të Kodit të Punës lidhur me kohëzgjatjen e kontratës së punës; nenin 143 i Kodit të Punës lidhur me afatin e njoftimit; nenin 144 pika 3 të Kodit të Punës lidhur me shkaqet e përligjura për zgjidhjen e kontratës së punës; nenin 153 të Kodit të Punës lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme; neni 11 i Kodit të Punës lidhur me hierarkinë e normave; neni 93 paragrafi i dytë i Kodit të Punës lidhur me përcaktimin e datës së fillimit të pushimeve vjetore të paguara; neni 37 dhe neni 159 i Kodit të Punës lidhur me masat disiplinore ndaj punëmarrësit; nenet 22-26 të Kodit të Punës lidhur me detyrimet e punëmarrësit; nenin 155 I Kodit të Punës lidhur me masën e dëmshpërblimit.

Në paditë me objekt: *“Zgjidhje martesë” dhe “Zgjidhje martesë dhe rregullimin e pasojave”*,⁶⁰ Gjyqtari identifikon: nenin 132 të Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës; neni 146 i Kodit të Familjes, lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës sa i takon mbiemrit; neni 2 i Kodit të Familjes lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës; neni 125 i Kodit të Familjes lidhur me zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok; neni 129 i Kodit të Familjes lidhur me zgjidhjen e martesës për ndërprerje të jetesës së përbashkët; ; nenin 155 të Kodit të Familjes lidhur me detyrueshmërinë e marrjes së mendimit të ekspertit psikolog; nenet 192-197 të Kodit të Familjes lidhur me detyrimin për ushqim.

⁵⁸ Vendim nr. 368, datë 27.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 193, datë 24.05.2021, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁹ Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁰ Vendim nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 18, datë 27.01.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në kërkesën civile pa palë kundërshtare, me objekt: “Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e kredisë”,⁶¹ Gjyqtari identifikon nenin 481 të Kodit Civil për njoftimin e detyrimit; Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë“, lidhur me subjektet që mund të lidhin kontrata kredie.

Në çështjen në të cilën disponon me vendim moskompetence⁶², me objekt “Detyrimin e të paditurve që të na njohin të drejtën e rimbursimit për blerjen e karburanteve”, Gjyqtari identifikon normat materiale: nenin 8 të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”; Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 723 datë 19.11.1998 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”.

Në padinë me objekt: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”⁶³ Gjyqtari identifikon Ligjin nr. 8662 datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumimit të energjisë elektrike” (neni 1); Ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (neni 36); Ligji nr. 43/2015 datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” (nenet 76, 79); nenet 772-783 të Kodit Civil lidhur me kontratën e furnizimit; Vendimi i ERE nr. 109 datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”; Rregullore e ERE nr. 203 datë 18.12.2017 “Mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”; neni 137 i Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike apo impulsive telefonike”; nenin 681 të Kodit Civil lidhur me interpretimin subjektiv dhe kontekstual të kontratës; nenin 655 të Kodit Civil lidhur me begatimin pa shkak.

Në padinë me objekt: “Lëshimin e urdhërit të mbrojtjes”⁶⁴, Gjyqtari identifikon nenin 9 të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar (në vijim “Ligji nr. 9669/2006”) lidhur me gjykatën ku mund të ngrihet padia për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes; nenin 1/3 të Ligjit nr. 9669/2006, lidhur me legjitimim aktiv dhe pasiv të palëve nëse konsiderohen “pjesëtarë të familjes”; nenin 3 të Ligjit nr. 9669/2006 lidhur me përkufizimin e dhunës; nenin 15 të Ligjit nr. 9669/2006 lidhur me provat që administrohen në procesin e urdhërit të mbrojtjes; nenin 20 të Ligjit nr. 9669/2006 lidhur me urdhëron e menjëhershëm të mbrojtjes; nenin 19 të Ligjit nr. 9669/2006 lidhur me rastet e caktimit të masave mbrojtëse.

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes dhe ligjeve të posaçme si më sipër, Gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si më poshtë:

- neni 122 i Kushtetutës lidhur me epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj që kanë epërsi mbi të drejtën e brendshme në rast mospajtimi⁶⁵; (*marrëdhënie pune*)

⁶¹ Vendim nr. 9, datë 19.01.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶² Vendim nr.136, datë 07.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶³ Vendim nr. 268, datë 13.10.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁴ Vendim nr. 28, datë 13.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁵ Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

- Konventa Nr. 182 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës” e vitit 1982; Konventa nr. 158 të ILO dhe Rekomandimin nr. 166 “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”⁶⁶; (*marrëdhënie pune*)
- nenin 42 të Kushtetutës lidhur me juridiksionin gjyqësor civil⁶⁷; nenet 7,11, 17 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” lidhur me kompetencën e gjykatave administrative⁶⁸. (*mosmarrëveshje administrative*)

Në vendimet penale, Gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit si dhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, si më poshtë:

Identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal dhe analizës së elementëve të figurës së veprës penale:

- nenin 284/2 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” në bashkëpunim; Ligji nr. 8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope” lidhur me kuptimin e kultivimit.⁶⁹;
- nenin 278/1 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, i armëve shpërthyes dhe municionit”; Ligji nr. 74/2014 “Për armët” (neni 3)⁷⁰;
- nenin 248 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”; Kodi Doganor miratuar me Ligjin nr. 102/2014 në lidhje me Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në Sistemin SYCADA WORLD”⁷¹;
- nenin 186/3 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”; Udhëzim nr. 1, datë 18.01.2012 “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre”; Udhëzim Nr. 9 datë 09.12.1999 “Mbi disa probleme që lidhen me përfaqësimin në doganë“ aktualisht i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të procedurave për miratimin dhe përfaqësimin në doganë“; VKM nr. 205 datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”⁷²;
- nenet 85 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të “Vrasjes nga pakujdesia”⁷³;
- nenin 91 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia”⁷⁴;

⁶⁶ Vendim nr. 175, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁷ Vendim nr.136, datë 07.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁸ Vendim nr.136, datë 07.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁹ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁰ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷¹ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷² Po aty.

⁷³ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁴ Po aty.

- nenin 88/2 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Plagosje së rëndë me dashje me pasojë vdekjen*”⁷⁵;
- nenin 89 të Kodit Penal lidhur me veprën penale “*Plagosje e lehtë me dashje*”⁷⁶;
- nenin 90 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të “*Dëmtime të tjera me dashje*”⁷⁷;
- neni 280 i Kodit Penal lidhur me veprën penale të “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*”⁷⁸;
- neni 291 i Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “*Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt*” në lidhje me Kodin Rrugor⁷⁹;
- nenin 301 i Kodit Penal lidhur me veprën penale të “*Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës*”⁸⁰;
- nenet 130/a/4 dhe 124/b/1 të Kodit Penal të ndryshuar me Ligjin nr. 35/2020 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 72/2020 dhe që ka hyrë në fuqi në datën 08.05.2020 lidhur me figurat e veprave penale të “*Dhunës në familje*” dhe “*Keqtrajtimit të të miturit*”⁸¹;
- nenin 236/2 të Kodit Penal lidhur me veprën penale “*Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik*”⁸²;
- nenet 242, 134/1, 130/a/1 të Kodit Penal lidhur me veprat penale të “*Mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik*” “*Vjedhjes*” dhe “*Dhunë në familje*” të dyshuara se janë kryer nga i arrestuari⁸³.
- nenet 290 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “*Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor*” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, i trajtuar në harmoni dhe interpretim sistematik me nenet 89 dhe 88 të Kodit Penal, ku parashikohen figurat e veprës penale të “*Plagosjes së lehtë me dashje*” dhe “*Plagosjes së rëndë me dashje*”⁸⁴.
- nenin 134 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “*Vjedhjes*”⁸⁵,
- nenin 199/a të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Ndërtimi i paligjshëm*”, në lidhje me nenin 3 të ligjit të posaçëm Nr. 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*” si dhe me nenin 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408 datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”⁸⁶.

*Referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konkretisht: nenin 19 i Kodit Penal lidhur me mbrojtjen e nevojshme*⁸⁷; nenet 22 -23 të Kodit Penal lidhur me

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸² Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸³ Vendim nr. 38, datë 15.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸⁴ Vendim nr. 127, datë 09.06.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

⁸⁵ Vendim nr. 99, datë 20.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸⁶ Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendimin nr. 81, datë 16.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸⁷ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

tentativën⁸⁸; nenin 34 paragrafi 3 të Kodit Penal lidhur me dënimin me gjobë⁸⁹; neni 39 i Kodit Penal lidhur me dënimin plotësues për heqjen e së drejtës për të ushtruar profesionin e agjentit doganor⁹⁰; nenin 47 të Kodit Penal lidhur me parimin e individualizimit të dënimit⁹¹; nenet 48 -49 të Kodit Penal lidhur me rrethanat lehtësuese⁹²; neni 55 i Kodit Penal lidhur me bashkimin e dënimeve⁹³; nenin 50 pika “a” të Kodit Penal lidhur me motivet e dobëta si rrethana rënduese⁹⁴; neni 59 i Kodit Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë⁹⁵; nenin 63 të Kodit Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe kryerjen e një pune në interes publik⁹⁶; nenin 66 të Kodit Penal, ku parashikohen rastet e parashkrimit të ndjekjes penale,⁹⁷ etj.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, Gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 6 paragrafi i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me arsyetimin e vendimeve⁹⁸;
- nenin 17/1 të Kushtetutës lidhur me drejtësinë dhe proporcionalitetin e dënimit⁹⁹;
- nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me procesin e rregullt ligjor¹⁰⁰;
- nenet 27 të Kushtetutës dhe neni 5 pika c të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me kufizimin e lirisë me një vendim gjyqësor¹⁰¹.

Sa i përket konfliktit të normave, nga tërësia e vendimeve gjyqësore burim vlerësimi konstatohet se në ato raste ku analiza e konfliktit të normave ka qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit lidhur me zgjidhjen e çështjes, Gjyqtari ka arritur të identifikojë normën penale të aplikueshme. Kështu, në Vendimin nr. 169, datë 10.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjyqtari interpreton dhe krahason dy figurat e veprës penale, nenin 89 të Kodit Penal “Plagosje e lehtë me dashje” me nenin 90 të tij, ku parashikohet “*Rrahja*” e

⁸⁸ Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸⁹ Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹⁰ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹¹ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹² Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

⁹³ Vendim nr. 66, datë 02.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 43, datë 17.03.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

⁹⁴ Vendim nr. 169, datë 10.11.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹⁵ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 227, datë 15.12.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; Vendim nr. 82, datë 28.07.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;

⁹⁶ Vendim nr. 158, datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹⁷ Vendim nr. 99, datë 20.05.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹⁸ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹⁹ Vendim nr. 111, datë 02.06.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰⁰ Vendim nr. 128, datë 05.07.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰¹ Vendim nr. 38, datë 15.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

cila ndiqet me ankimin e viktimës akuzuese sipas nenit 58 e 59 të Kodit Penal, dhe dallimi tjetër qëndron tek paaftësia e përkohshme që duhet të vijë tek “Rrahja” deri në nëntë ditë. Ndërsa, në Vendimin nr. 111, datë 02.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjyqtari analizon katër elementët e figurave së veprës penale të “Vrasjes nga pakujdesia” të parashikuar në nenin 85 të Kodit Penal dhe të “Plagosjes së rëndë nga pakujdesia” të parashikuar nga neni 91 i Kodit Penal, si dhe neni 88/2 të Kodit Penal sa i përket figurës së veprës penale të “Plagosjes së rëndë me dashje me pasojë vdekjen” në raport me rrethanat e faktit për të analizuar pretendimet e trashëgimtarëve të viktimës duke analizuar anën subjektive, pakujdesinë e kryerjes së veprimeve të kundërligjshme pa dëshiruar pasojën e ardhur. Po ashtu, në Vendimin nr. 127, datë 09.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjyqtari analizon figurën e veprës penale e “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Duke qenë se neni 290 i Kodit Penal është dispozitë blankete, pasi nuk përcakton nocionet e plagosjes së lehtë apo të rëndë, në vendim referohet në normat juridike penale konkrete 89 dhe 88 të Kodit Penal.

KONKLUZIONI

Në tërësi, Gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, i) si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ii) ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitikë, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Evidentohet aftësi e lartë e Gjyqtarit në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga Gjyqtari lidhur me zbatimin e tij. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Gjyqtari i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtari kryesisht

përdor interpretimin *teologjik*, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përqsasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, duke e analizuar më pas normën në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se:

- Interpreton në mënyrë sistematike kuadrin ligjor e nënligjor të zbatueshëm: Ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronave dhe përfundimin e procesit të kompensimit”; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 222 datë 23.03.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës”; ku përcaktohet se paditësi ka detyrimin të paraqes dokumentacion ligjor i cili konsiston në dokument hipotekor, kadastral, arkivor, vendime të mëparshme të ish KKKP-ve, dokument që vërteton heqjen ose marrjen e së drejtës së pronësisë nga shteti në mënyrë të padrejtë që nga data 29.11.1944 etj.
- Interpreton dhe analizon nenin 163 të Kodit Civil lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë të cilat i ndan në origjinale (fitimi i pronësisë për herë të parë ose pa vullnetin e pronarit) dhe të prejardhur (fitimi në bazë të vullnetit të pronarit). Gjyqtari analizon një ndarje tjetër është ajo që parashikon Kodi Civil (trashëgimi, kontratë, parashkrimi fitues, fitimi me bashkim e përzierje etj.) dhe në bazë të ligjeve të veçanta (Ligji nr. 7501/1991 “Për tokën”; Ligji nr. 7698/1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”; Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; Ligji nr. 111/2018 “Për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”. etj.)
- Lidhur me efektet e regjistrimit të pronës në regjistrin kadastral, Gjyqtari ka referuar përmbajtjen e Vendimit Unifikues nr. 1 datë 06.01.2009 duke theksuar se regjistrimi apo transkriptimi ka efekt publiciteti dhe nuk krijon të drejta pronësore mbi sendin. (vendimi nr. 368 date 27.11.2020)
- Citon dhe interpreton nenin 140 të Kodit të Punës duke përcaktuar se kontrata me afat të caktuar duhet të justifikohet me arsye objektive që lidhen me natyrën e përkohshme të detyrës.
- Interpreton Kodin e Punës sa i përket mënyrave të zgjidhjes së kontratës së punës: normale dhe e jashtëzakonshme. Sa i përket të parës, analizon se duhet të plotësohen disa kushte: vullneti i njëjës palë, respektimi i afatit ligjor të njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Punës; ekzistenca e një shkakut të ligjshëm (aftësia, sjellja, kërkesat operationale) konform nenit 144 pika 3 të Kodit të Punës.
- Interpreton dhe analizon nenin 153 të Kodit të Punës lidhur me shkaqet e justifikuar për zgjidhjen e kontratës së punës me efekt të menjëhershëm (punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë; punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë në mënyrë të përsëritur me gjithë lajmërimin me shkrim të punëdhënësit). Në këtë linjë,

arsyeton lidhur me kushtet kumulative që duhet të plotësohen në lidhje me zgjidhjen në mënyrë të justifikuar të kontratës së punës: i. punëmarrësi të ketë shkelur një detyrim kontraktor; ii. Shkelja të jetë me faj të rëndë ose të lehtë në mënyrë të përsëritur pas një paralajmërimi; ekzistenca e lidhjes shkakësore midis shkeljes dhe zgjidhjes së menjëhershme të kontratës; shkelja të ketë cenuar raportin e besimit midis palëve kontraktuese.

- Interpretin nenet 22-26 të Kodit të Punës për të sintetizuar detyrimet e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit: detyrimi i kryerjes së punës personalisht; detyrimin e bindjes ndaj urdhërave dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit; detyrimi i kujdesit në punë dhe detyrimi i besnikërisë.
- Interpretin nenet 37, 159 të Kodit të Punës lidhur me masat disiplinore, të cilat nuk duhet të cenojnë elementët thelbësore të kontratës së punës. Lidhur me respektimin e këtij parimi, përmend në vendim praktik të Gjykatës së Lartë (Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 553 datë 04.12.2012) dhe interpretin aktet ndërkombëtare në mënyrë sistematike, Konventën nr. 158 të ILO dhe Rekomandimin nr. 166 “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për të konkluduar se dhënia e masave disiplinore duhet të mbajë parasysh parimin e proporcionalitetit midis rëndësisë së shkeljes së detyrimit kontraktor dhe masës disiplinore.
- Interpretin nenin 144 të Kodit të punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës që duhet të respektohet në mënyrë rigoroze nga punëdhënësi, sepse nuk është një kërkesë formale e Kodit të Punës, por qëllimi i saj është njohja e punëmarrësit me mundësinë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe ballafaqimin me pretendimet e punëdhënësit. *Vendimin nr. 175, datë 02.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*
- Trajton institutin e martesës si një veprim juridik që konsiston në krijimin e një bashkëjetese ligjore që mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit e mirëkuptimit reciprok.
- Interpretin nenin 132 të Kodit të Familjes, duke e cituar atë, më pas duke e shtjelluar në një analizë të detajuar të tri kushteve kumulative për zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, konkretisht: të ekzistojë shkak për zgjidhjen e martesës; jetesa e përbashkët të jetë e pamundur dhe martesë të ketë humbur qëllimin e saj; të ekzistojë lidhja shkakësore midis shkakut të pretenduar dhe pamundësisë së jetesës së përbashkët. Secili prej kushteve analizohet dhe shpjegohet nga Gjyqtari i cili i aplikon ato në rrethanat e rastit konkret.
- Interpretin nenin 146 të Kodit të Familjes lidhur me pasojën juridike të zgjidhjes së martesës sa i takon mbiemrit, duke cituar dispozitën përkatëse dhe duke e aplikuar atë në rrethanat e rastit konkret.
- Interpretin dhe zbaton nenin 134 të Kodit të Familjes lidhur me seancën e pajtimit për të shpjeguar ecurinë procedurale të çështjes.
- Interpretin nenin 2 të Kodit të Familjes lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, se përfshin një problematikë mjaft komplekse dhe se vlerësimi për respektimin ose jo të këtij parimi themeltar bëhet rast pas rasti, në vartësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe se gjykata duhet të zgjedhë alternativën që i përshtatet interesit më të lartë të fëmijës. Ky interpretim mbështetet duke referuar në praktikën e Gjykatës së Lartë

(Vendimi nr. 357, datë 11.09.2008 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 202 datë 24.04.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 188 datë 08.05.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.)

- Në interpretim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe praktikës gjyqësore thekson se është në interes të fëmijëve që t'u lihen të gjithë fëmijët për rrije dhe edukim njërit prind, por në raste përjashtimore mund të disponohet ndryshe, i diktuar nga kushtet sociale dhe rrethanat në të cilat kanë jetuar fëmijët.
- Interpreton sistematikisht nenet 197 të Kodit të Familjes lidhur me detyrimin për ushqim të prindit ndaj fëmijës, si dhe nenet 197 -214 të Kodit të Familjes lidhur me ekzistencën e dy kushteve kumulative për t'u aplikuar detyrimi për ushqim: së pari, fëmija të mos ketë të ardhura të mjaftueshme për të jetuar; së dyti; fëmija të jetë i mitur. Pas këtij interpretimi, i përshtat në rrethanat e rastit konkret duke mbajtur parasysh mundësitë ekonomike të të detyruarit si dhe moshën e fëmijës. (Vendimin nr. 36, datë 10.02.2022 Në Vendimin nr. 295, datë 01.11.2022 i Vendimin nr. 18 datë 27.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Në Vendimin nr. 193, datë 27.07.2020",)
- Në këtë spektër, interpreton nenin 510 pika "d" të Kodit të Procedurës Civile, dhe arsyeton se që akti të përbëjë titull ekzekutiv duhet të përmbushë këto kushte: të jetë kontratë kredie; të jetë institucion financiar bankar ose institucion financiar jobankë I licensuar; kontrata të jetë në formë të shkruar dhe detyrimi të jetë bërë i kërkueshëm, të jetë I përcaktuar saktë, të prezumohet i vërtetë. Në vijim të kësaj analize, për të konkluduar nëse kërkuesi është institucion financiar i licensueshëm referon në ligjin e posaçëm Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" lidhur me subjektet që mund të lidhin kontrata kredie. Lidhur me faktin nëse detyrimi është bërë i kërkueshëm, Gjyqtari interpreton dhe aplikon në rrethanat e rastit konkret nenin 481 të Kodit Civil. (Vendimin nr. 9, datë 19.01.2021,)
- Interpreton secilin kriter ligjor të parashikuar në nenin 19 të Ligjit nr. 9669/2006 duke e përqasur dhe aplikuar atë në rrethanat e rastit, dhe konkretisht analizon se: ekzistojnë bazat për të besuar se i padituri (dhunuesi) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës; lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës. (Vendimin nr. 28 datë 13.10.2020,)
- Citon dhe interpreton nenin 681 të Kodit Civil lidhur me interpretimin subjektiv dhe kontekstual të kontratës, sipas të cilit kur interpretohet një konkretë duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin literal të fjalëve dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës. (Vendimin nr. 268 datë 13.10.2022,)

Në vendimet penale Gjyqtari interpreton dispozitat materiale (nenet 284/2 e 278/1, 279/2, 236/1, 283, 291, 277, 186, 102 e 22 të Kodit Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjyqtari interpreton në nivel teorik normën relevante të K. Penal,

duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përjasur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.¹⁰²

Më konkretisht, Gjyqtari:

- Citon, interpreton dhe analizon në të katër elementët e tij nenin 280 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve të gjuetisë dhe sportive*”. Në këtë linjë, lidhur me objektin përcaktohet se ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar rendin dhe sigurinë publike nga prodhimi, mbajtja, shitja, blerja e armëve të gjahut dhe sportive pa lejen e organeve kompetente, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal; ana objektive: kryhet me veprime aktive që përcaktohen shprehimisht në dispozitë. Lidhur me kuptimin e armëve zjarri për gjueti dhe armë sportive, Gjyqtari referon në Ligjin e posaçëm Nr. 74/2014 “Për armët”.
- Citon, interpreton dhe analizon në të katër elementët e tij nenin 291 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt*”. Në këtë linjë, lidhur me objektin përcaktohet se ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar qarkullimin e rregullt rrugor të mjeteve, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal; ana objektive: kryhet me tri forma: i) me drejtimin e mjeteve në gjendje të dehur; ii) me drejtimin e mjeteve nën efektin e lëndëve narkotike; iii) me drejtimin e mjeteve pa certifikatën përkatëse të aftësisë. Duke qenë dispozitë blankete neni 291 i Kodit Penal, referon në nenin 115 të Kodit Rrugor ku përcaktohet kategoria e mjeteve dhe lejet e drejtimit përkatëse të nevojshme.
- Citon, interpreton dhe analizon në të katër elementët e tij nenin 301 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*”. Në këtë linjë, lidhur me objektin përcaktohet se ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve të sistemit të drejtësisë, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal; ana objektive: kryhet me forma të caktuara të parashikuara shprehimisht në ligj; ana subjektive: me qëllimin e posaçëm të pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës dhe përjas rrethanat e çështjes mbi këtë figurë të veprës penale (*Vendimin nr. 111, datë 02.06.2022*)
- Citon, interpreton dhe analizon në të katër elementët e tij nenin 236/2 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit publik*”. Në këtë linjë, lidhur me objektin përcaktohet se ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar regjimin, veprimtarinë e rregullt të organeve të policisë së rendit publik, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal; ana objektive: kryhet me veprime aktive duke e penguar punonjësin e policisë të kryejë detyrën sipas ligjit dhe në rrethana cilësuese vepra kryhet: duke ushtruar dhunë fizike, në bashkëpunim, më shumë se një herë. Lidhur me kuptimin e dhunës, Gjyqtari interpreton se do të kuptohet “çdo kundërshtim fizik që i bëhet punonjësit të policisë,

¹⁰²Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes

si me anë të goditjes me grushte, sende të forta, kapjes për trupi, shtyrjeve, kacafytjeve etj”.” (*Vendimin nr. 227, datë 15.12.2022,*)

- Interpreton dhe analizon nenin 89 të Kodit Penal ku parashikohet figura e veprës penale e “Plagosjes së lehtë me dashje” parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, në të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive. Në këtë spektër, arsyetohet se vepra ka për objekt marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar shëndetin e personit nga veprimet kriminale; nga ana objektive kryhet me veprime aktive, me mënyra dhe mjete të ndryshme si duke e goditur me dru, hekur, grushte, etj., dhe se është një vepër penale materiale që kërkon ardhjen e pasojës, plagosjen me paaftësi të përkohshme në punë mbi nëntë ditë.
- Interpreton dhe krahason dy figurat e veprës penale, nenin 89 të Kodit Penal me nenin 90 të tij, ku parashikohet “Rrahja” e cila ndiqet me ankimin e viktimës akuzuese sipas nenit 58 e 59 të Kodit Penal, dhe dallimi tjetër qëndron tek paaftësia e përkohshme që duhet të vijë tek “Rrahja” deri në nëntë ditë. (*Vendimin nr. 169, datë 10.11.2021*)

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (të pjesës së posaçme) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, Gjyqtari zbaton dhe në disa raste interpreton edhe dispozita të ligjeve të posaçme ku referon faktin penal. Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast Gjyqtari interpreton *dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal*, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- Interpreton ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale duke cituar përmbajtjen e nenit 375 të Kodit Penal, në lidhje me nenin 403 të Kodit Penal ku parashikohet pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar nëse çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në këtë linjë, arsyetohet se me zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, jurisprudenca kushtetuese ka interpretuar se kuptohet jo vetëm që çështja mund të zgjidhet me provat që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por çështja mund të zgjidhet për të njëjtën akuzë dhe nëse nevojitet ndryshimi i akuzës, gjykata do të rrëzojë kërkesën për gjykimin e shkurtuar, pasi ky rit gjykimi nuk mund të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë.
- Interpreton nenet 403-406 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me institutin e gjykimit të shkurtuar, si një gjykim i posaçëm që mund të kërkohet nga i pandehuri ose mbrojtësi me prokurë të posaçme dhe ka si thelb të tij pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, si dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to, rrit shpejtësinë e gjykimit dhe ul masën e dënimit të të pandehurit, nuk nënkupton pafajësi, por pranimin e provave të prokurorisë dhe gjykata mund të vendosë fajësi, pafajësi ose pushimin e çështjes. Analiza e këtij instituti bëhet duke referuar praktikën unifikuese, Vendimin Unifikues nr. 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Interpreton nenin 151 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me çmuarjen e provave dhe mosdhënien asnjë prove vlerë të paracaktuar nga ligji, si dhe nxjerrjen e një fakti nga indicjet e rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra –tjetrën. Në këtë kontekst,

analizon se vepra penale është kryer në bashkëpunim, pasi analizon të gjitha indicjet e rastit konkret.

- Interpretin institutin e dënimit, i cili ka për qëllim parandalimin e përgjithshëm, edukimin e shtetasve dhe parandalimin e posaçëm, i cili ka të bëjë me autorin e veprës penale dhe që synon edukimin e tij.
- Interpretin dhe aplikojnë nenet 48-49 të Kodit Penal lidhur me rrethanat lehtësuese, konkretisht kushtet ekonomike të vështira, ndërsa për sa përket pëndësës gjyqtari nuk e merr të besueshme sepse ai është përpjekur që të mbajë përsipër fajësinë e vetëm.
- Trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit me kusht zbatimit të provës, duke përcaktuar se funksioni kryesor i tij është nevoja e individualizimit dhe caktimit të dënimit të mundësisë së riedukimit duke e pezulluar dënimin për një periudhë mbikqyrje të caktuar. Në këtë kuadër, referon në praktikën gjyqësore, Vendim nr. 48 datë 01.04.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari interpretin nenin 59 të Kodit Penal, duke identifikuar kushtet e kriteret e nevojshme për aplikimin e tij: ekzistenca e rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe të nevojave veçanërisht të atyre që lidhen me familjen shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale; dënim me burgim deri 5 vjet; kontakte me shërbimin e provës dhe moskryerjen e veprës tjetër penale. Këto kriteret ligjore aplikohen në rrethanat e rastit konkret, ku secila kërkesë ligjore arsyetohet me rrethanat konkrete familjare dhe personale, shoqëruar me akte provuese të personalitetit të të pandehurit.
- Interpretin dhe aplikojnë nenet 48-49 të Kodit Penal lidhur me rrethanat lehtësuese, konkretisht: mosqenien i dënuar më parë dhe rrezikshmëria e ulët e të pandehurit (për të pandehurin A.D) dhe moshën e të pandehurit, mosqenien i dënuar më parë (për të pandehurin H.P).
- Trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit me kusht zbatimit të provës, duke përcaktuar se funksioni kryesor i tij është nevoja e individualizimit dhe caktimit të dënimit të mundësisë së riedukimit duke e pezulluar dënimin për një periudhë mbikqyrje të caktuar. Në këtë kuadër, referon në praktikën gjyqësore, Vendim nr. 48 datë 01.04.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjyqtari interpretin nenin 59 të Kodit Penal, duke identifikuar kushtet e kriteret e nevojshme për aplikimin e tij: ekzistenca e rrezikshmërisë së pakët të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyra e jetesës dhe të nevojave veçanërisht të atyre që lidhen me familjen shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale; dënim me burgim deri 5 vjet; kontakte me shërbimin e provës dhe moskryerjen e veprës tjetër penale. Këto kriteret ligjore aplikohen në rrethanat e rastit konkret, ku secila kërkesë ligjore arsyetohet me rrethanat konkrete familjare dhe personale, shoqëruar me akte provuese të personalitetit të të pandehurit.
- Interpretin nenin 63 të Kodit Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe kryerjen e një pune në interes publik duke përcaktuar kuptimin e këtij instituti, përmes citimit të normës dhe zërthimit të nenit 63 të Kodit Penal: rrezikshmëri e pakët, dënim deri në 1 vit, i pandehuri jep pëlqimin, puna të kryhet brenda 6 muajve,

kohëzgjatje 40-240 orë pune në interes publik; i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. *Vendimin nr. 158, datë 28.10.2021*

- Trajton institutin e arrestimit në flagrancë si një kufizim i përkohshëm i lirisë së personit në kompetencë gjyqësore, përmes interpretimit literal dhe qëllimor të nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale. Interpretimi i nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, mbështetet nga interpretimi sistematik i neneve kushtetuese dhe konventore, neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 gërma c e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilëve, arrestimi në flagrancë kryhet me qëllim që personi t'i dërgohet një autoriteti gjyqësor kompetent, i cili më pas bën vlerësimin nëse është i ligjshëm arrestimi apo ndalimi. Interpreton sistematikisht nenet 251 -259 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kushtet për vleftësimin e arrestimit në flagrancë, konkretisht: të ekzistojë gjendja e flagrancës; personi të jetë i dyshuar për kryerjen e veprave penale me kufij dënimi sipas nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale; kërkesa të paraqitet në gjykatë brenda 48 orëve nga arrestimi I personit në flagrancë. Trajton institutin e masave të sigurimit si një kufizim i përkohshëm i të drejtave dhe lirive të personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, i dhënë me vendim të gjykatës; jo masa ndëshkimore, por të nevojshme për procesin e hetimit (grumbullimin e provave). Ky trajtim bëhet përmes referencës në praktikën e Gjykatës së Lartë (Vendim nr. 489 datë 12.12.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 33 datë 08.09.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.) Interpreton nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit e drejta për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit i përket organit të prokurorisë, dhe gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo që ka kërkuar prokurori. Interpreton nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kushtet e përgjithshme që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, për caktimin e një mase sigurimi, konkretisht: ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale; ekzistenca e veprës penale; vepra penale të mos jetë shuar ose të mos ekzistojë një shkak padënueshmërie. Në këtë kontekst trajton konceptet e “dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova”, “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, “prova”, dhe referimi bëhet në praktikën Unifikues (Vendimi Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.) Interpreton paragrafin e tretë të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kushtet e posaçme për caktimin e masës së sigurimit, konkretisht: të ekzistojnë shkaqe që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën procedohet. Interpreton nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me kriteret e veçanta që duhet të mbahen parasysh në caktimin e masës së sigurimit, dhe që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e masës së sigurimit me shkallën e nevojave; masa në raport me rëndësinë e faktit dhe seksionin; vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal, si dhe thekson interesin më të lartë të të miturit e mosndërprerjen e procesit edukativ konkret, kur i pandehuri është në moshë të tillë. *Vendimin nr. 38, datë 15.03.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (me objekt: Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.*

- Interpreteton dhe aplikon nenin 34 paragrafi i tretë dhe i gjashtë, që lidhet me aplikimin e dënimit me gjobë, pasi ka mbajtur parasysh mundësitë ekonomike të të pandehurit. Ky interpretim mbështetet në jurisprudencën kushtetuese, pasi referohet në Vendimin nr. 19 datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese. (*Vendimin nr. 169, datë 10.11.2021*)

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, Gjyqtari i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake; në çështjet në të cilat është vendosur pushimi i gjyqimit, etj. Konkretisht:

- Në vendimet penale¹⁰³ me objekt gjykimin në themel të akuzave të paraqitura, përshkruhet procedura e ndjekur, duke cituar vendimmarrjet e Gjyqtarit të Seancës paraprake që ka vendosur plotësimin e hetimeve për të hetuar në drejtim të përgjegjshmërisë penale të të pandehurit konform nenit 332/ç të K.Pr.Penale; ka dërguar çështjen për gjykim, së bashku me kërkesën për gjykim të shkurtuar, faktin se i pandehuri i ka qëndruar kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe citon nenet 332/dh pika 1, shkronja “c”, 403/2, 128/a, 405/6 të K.Pr.Civile si dhe Vendimin Unifikues 2/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilin e interpreton në lidhje me faktet procedurale dhe konkludon në pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar nga gjykata.
- Interpreteton nenet 69, 74, 75, 13, 15-18, 76 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me juridiksionin, me kompetencën lëndore, me përbërjen e trupit gjykues, me mungesën e shkaqeve të përjashtimit; me kompetencën tokësore dhe aplikohen në faktet procedurale konkrete *Vendimin nr. 111, datë 02.06.2022*.
- Në vendimet penale me objekt gjykimin e çështjeve në seancë paraprake (dërgim në gjyq)¹⁰⁴, Gjyqtari përshkruan ecurinë procedurale në seancë paraprake mbi caktimin e seancës dhe interpreton nenin 151 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me çmuarjen e provave dhe mosdhënien asnjë prove vlerë të paracaktuar nga ligji, si dhe nxjerrjen e një fakti nga indicjet e rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra –tjetrën. Në këtë kontekst, analizon se vepra penale është kryer në bashkëpunim, pasi analizon të gjitha indicjet e rastit konkret. Interpreteton institutin e dënimit, i cili ka për qëllim parandalimin e përgjithshëm, edukimin e shtetasve dhe parandalimin e posaçëm, i cili ka të bëjë me autorin e veprës penale dhe që synon edukimin e tij.
- Interpreteton nenin 6 paragrafi i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me arsyetimin e vendimeve si pjesë e procesit të rregullt gjyqësor, duke i dhënë argumentet çdo pretendimi të ngritur nga palët. Ky interpretim bëhet duke përmendur Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Van de Hurk kundër Holandës (1994); Latournerie kundër Francës (2002); Vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe Nr. 38 datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese, Vendimi nr. 74 datë 04.11.2021 dhe nr. 59 datë 22.02.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Interpreteton nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me shpenzimet gjyqësore, duke ia ngarkuar ato të pandehurit sa kohë që u deklarua fajtor (*Vendimin nr. 111, datë 02.06.2022*)

¹⁰³ Ne te gjitha vendimet penale

¹⁰⁴ Vendimi nr.177 date 13.10.2020

- Interpreton dhe aplikon nenin 350 të Kodit të Procedurës Penale mbi faktet proceduriale duke cituar se mbrojtësi nuk është paraqitur në zbatim të Vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatëve nr.2 datë 29.06.2022, në të cilin është vendosur bojkotimi i të gjitha proceseve gjyqësore civile, penale dhe administrative si masë ekstreme e ndërmarrë nga ky organ për kundërshtimin e hartës së re gjyqësore. Gjyqtari ka interpretuar se mbrojtësi nuk ka pengesë të ligjshme në kuptim të nenit 350 të Kodit të Procedurës Penale, pasi pengesa nuk është shkaktuar nga forca madhore apo shkak tjetër i justifikuar siç është gjendja shëndetësore. Megjithatë, është vlerësuar se akti nënligjor vendimi i DHKA nuk përlligj gjobitjen e avokatit. Nga ana tjetër, megjithëse është e detyrueshme sipas nenit 332/b të Kodit të Procedurës Penale, në disa rrethana përjashtimore, ekstreme, tepër të rralla, si rasti objekt gjykimi, kur të gjithë avokatët nuk pranojnë të realizojnë të drejtën e mbrojtjes, nuk pengon vazhdimësinë e gjykimit. (*Vendimin nr. 128, datë 05.07.2022*)
- Në vendimet me objekt “Zgjidhje martesë”¹⁰⁵, Gjyqtari citon dhe interpreton nenin 134 të Kodit të Familjes sa i përket seancës së pajtimit, duke sqaruar qëllimin e këtij momenti procedural në paditë me objekt zgjidhje martesë, i cili lidhet me dhënien e një mundësie palëve për të rimenduar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre dhe shmangien e zgjidhjes së martesës.
- Interpreton nenin 1/3 të Ligjit nr. 9669/2006, lidhur me legjitimim aktiv dhe pasiv të palëve nëse konsiderohen “pjesëtarë të familjes” dhe aplikon këto norma juridike në rrethanat e rastit duke përcaktuar se paditësi dhe i padituri janë vëllezër, pra janë pjesëtarë të një familje, ndaj kanë legjitimitet. Interpreton nenin 3 të Ligjit nr. 9669/2006 lidhur me përkufizimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Interpreton sistematikisht nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me barrën e provës së palës paditëse dhe nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me të provuarit të akuzës tej çdo dyshimi, dhe mban qëndrimin se, për shkak të qenies së një marrëdhënie juridike civile, proces me natyrë sensitive, hapësirë të gjerë të vlerësimit të fakteve nga gjykata, standarti i provueshmërisë në këtë proces nuk është “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, siç përcaktohet në të drejtën procedural penale Vendimin nr. 28, datë 13.10.2020, (*me objekt: Lëshimin e urdhërit të mbrojtjes*).
- Analizon parimin e disponibilitetit mbi bazën e interpretimit sistematik të neneve 2, 5, 6, 28, dhe 185 të Kodit të Procedurës Civile, duke e konsideruar si një nga parimet më të rëndësishme të procesit civil, sipas të cilit gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të palës së interesuar; se gjykata shprehet vetëm mbi atë që kërkohet dhe për gjithçka që kërkohet; se paditësi ka të drejtë të vërë në lëvizje gjykatën me anë të kërkesëpadisë, të përcaktojë objektin e mosmarrëveshjes, të përcaktojë ndërgjyqësinë, të kërkojë heqjen dorë nga e drejta e padisë si dhe të bëjë ankim ndaj vendimit. (*Vendimin nr.155, datë 20.04.2021*)
- Interpreton nenet 36, 41 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore të gjykatave, si dhe nenin 45 të këtij Kodi lidhur me kompetencën tokësore ekskluzive të saj. Citon dhe interpreton nenet 42, 47 të Kodit të Procedurës

¹⁰⁵ Vendimi nr. 36 datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; vendimi nr. 295 date 01.11.2022; vendimi nr.18 date 27.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; vendimi nr 193 date 27.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

Civile në harmoni me nenin 7 të Kodit të Punës lidhur me kompetencën tokësore të mosmarrëveshjeve të punës, duke deduktuar se kemi të bëjmë me kompetencë konkurruese pasi mosmarrëveshja mund të shqyrtohet nga: i) gjykata e vendit ku ka vendbanimin ose qendrën e padituri; ii) gjykata e vendit ku ka vendbanimin ose ku kryen zakonisht punën punëmarrësi; iii) gjykata e vendit ku ka qendrën e padituri tjetër; dhe më pas arsyetohet se paditësi ka ushtruar të drejtën e zgjedhjes së gjykatës kompetente konform nenit 54 të Kodit të Procedurës Civile dhe konkludon se Gjyqtari ka kompetencë në shqyrtimin e çështjes. *Vendimin nr. 175, datë 02.06.2022*

- Interpreton në mënyrë sistematike nenet 1, 32 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 42 të Kushtetutës lidhur me juridiksionin gjyqësor civil. Interpreton në mënyrë historike ndryshimet ligjore lidhur me ngritjen kryesisht të kompetencës nga Gjykata, duke trajtuar sistematikisht, nenet 45 dhe 46 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën lëndore, funksionale dhe ekskluzive si dhe nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me verifikimin kryesisht nga Gjykata të kompetencës lëndore në *vendimin nr.136, datë 07.07.2020*
- Vendimet Unifikues civile dhe penale si nr. 154/2000, 980/2000, nr. 5/2002, nr. 2/2003, nr. 1/2005, nr. 1/2009, nr. 1/2011, nr. 5/2012, nr. 3/2012, nr. 13/2018, vendim njesues KPGJL date 01.11.2021;
- Vendimet nr. 00-2019-55, datë 28.02.2019, nr. 00-2019-182., datë 08.04.2019 te Gjykatës së Lartë

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se Gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet Unifikues të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Lidhur me efektet e regjistrimit të pronës në regjistrin kadastral, Gjyqtari ka referuar përmbajtjen e Vendimit Unifikues nr. 1 datë 06.01.2009 duke theksuar se regjistrimi apo transkriptimi ka efekt publiciteti dhe nuk krijon të drejta pronësore mbi sendin.
- Trajton institutin e gjësë së gjykuar (res judicata) sa i përket vendimmarrjes së ish komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave në rast se ndaj tij nuk ushtrohet ankim, duke e bërë atë përfundimtar, të pamundur për t'u ngritur sërish e njëjta padi/kërkesë, me të njëjtat palë, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak juridik. Ky institute trajtohet në lidhje me parimin e sigurisë juridike si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës, që përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normative, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një shtate të favorshme ligjore. *Në këtë linjë përmend jurisprudencën evropiane dhe atë kushtetuese, konkretisht: Vendim i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë; Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 27 datë 26.05.2010 duke cituar pjesë të përmbajtjes së tyre, si dhe referon në Vendimin Unifikues nr. 2 datë 21.02.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

- *Citon përmbajtjen e Vendimit nr. 30 datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kthimi dhe kompesimi i pronave ish pronarëve nuk bazohet në të drejtën e pronësisë, por në parimet e barazisë, drejtësisë dhe proporcionalitetit*
- Interpreton kontratën e kredisë si titull ekzekutiv si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, duke referuar në praktikën Unifikues Vendim Unifikues Nr. 980 datë 29.09.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit me kusht zbatimin e provës, duke përcaktuar se funksioni kryesor i tij është nevoja e individualizimit dhe caktimit të dënimit e mundësisë së riedukimit duke e pezulluar dënimin për një periudhë mbikëqyrje të caktuar. Në këtë kuadër, referon në praktikën gjyqësore, Vendim nr. 48 datë 01.04.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës.
- Lidhur me standartin e provueshmërisë referon në përmbajtjen e nenit 4/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë kuadër citon gjithashtu Vendimin Unifikues Nr. 7. Datë 15.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Citon nenin 17 të Kushtetutës dhe duke referuar në Vendimin nr. 3 datë 02.11.2015 të Kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë duke interpretuar sistematikisht nenin 47 të Kodit Penal lidhur me parimin e individualizimit të dënimit, i cili përmban proporcionalitetin mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që caktohet ndaj autorit të saj.
- Lidhur me respektimin e parimit që masat disiplinore nuk duhet të cenojnë elementët thelbësorë të kontratës së punës, përmend në vendim praktik të Gjykatës së Lartë (Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 553 datë 04.12.2012) dhe interpreton aktet ndërkombëtare në mënyrë sistematike, Konventën nr. 158 të ILO dhe Rekomandimin nr. 166 “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”, për të konkluduar se dhënia e masave disiplinore duhet të mbajë parasysh parimin e proporcionalitetit midis rëndësisë së shkeljes së detyrimit kontraktor dhe masës disiplinore.
- Trajton konceptet e “dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova”, “përtej çdo dysimi të arsyeshëm”, “prova”, dhe referimi bëhet në praktikën Unifikues (Vendimi Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.)
- Referon vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Van de Hurk kundër Holandës (1994); Latournerie kundër Francës (2002); Vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe Nr. 38 datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese, Vendimi nr. 74 datë 04.11.2021 dhe nr. 59 datë 22.02.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me interpretimin që i bën nenit 6 paragrafi i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me arsyetimin e vendimeve si pjesë e procesit të rregullt gjyqësor, duke i dhënë argumentet çdo pretendimi të ngritur nga palët.
- Referon jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që i përmbahet qëndrimit se nuk përbën pasuri bindja për ekzistencën e së drejtës së pronësisë, e cila për një kohë të gjatë nuk është shfrytëzuar në mënyrë të efektshme (Princi Hans – Adam II I Lihtenshtejn kundër Gjermanisë).
- Referon çështjet Manushaqe Puto kundër Shqipërisë, Beshiri kundër Shqipërisë, në bazë të të cilave është miratimi i Ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”. Në këtë kuadër përcaktohet objekti i ligjit, format e kompesimit të pronës (financiar, fizik); fusha e veprimit dhe pronat që përjashtohen; organet kompetente Agjensia e Trajtimit të Pronave (ATP); afati prekluziv për paraqitjen e kërkesave në ATP.

- Referon Konventën Nr. 182 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës” e vitit 1982 sa i përket të drejtës së mbrojtjes së punëmarrësit duke e analizuar si burim të së drejtës për zgjidhjen e çështjes
- neni 5 gërma c e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilëve, arrestimi në flagrancë kryhet me qëllim që personi t’i dërgohet një autoriteti gjyqësor kompetent, i cili më pas bën vlerësimin nëse është i ligjshëm arrestimi apo ndalimi.
- Vendime te gjykatave italiane në fushën penale si Cass. Pen., Sez. V, sent. n. 7012 del 1995; Cass. Pen., Sez. VI, sent. n. 145 del 1992.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i Gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e procesit të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës)* si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes,¹⁰⁶;
- *Parimi i sigurisë juridike* si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës, që përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normative, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore.¹⁰⁷
- *Parimin e hierarkisë së normave* të përcaktuar në nenin 11 të Kodit të Punës dhe 122 të Kushtetutës, dhe nenin 2 të Kodit të Punës lidhur me standartet e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare, sjell në vendim dhe analizon si burim të së drejtës për zgjidhjen e çështjes aktet ndërkombëtare Konventën Nr.182 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës” e vitit 1982 sa i përket të drejtës së mbrojtjes së punëmarrësit¹⁰⁸.
- *Parimin e disponibilitetit*, sipas të cilit gjykata shprehet vetëm për aq sa kërkohet¹⁰⁹.
- *Parimi i prezumimit të pafajësisë, element i të cilit është “in dubio pro reo”;*
- *Parimin e proporcionalitetit*, mes veprës penale të konsumuar dhe dënimit që i caktohet ndaj autorit të saj, në individualizimin e dënimit¹¹⁰.
- *Parimin e interesit më të lartë të fëmijës*¹¹¹ në çështjet ku përfshihen interesa të të miturit

KONKLUZIONI

¹⁰⁶ Vendim nr. 111 datë 02.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰⁷ Vendim nr. 368 datë 27.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰⁸ Vendim nr. 36, datë 02.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁰⁹ Vendim nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe në Vendimin nr. 18 datë 27.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹¹⁰ Ne te gjitha vendimet penale të themelit

¹¹¹ Vendim nr. 36, datë 10.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; vendim nr. 295, datë 01.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, vendim nr. 193, datë 27.07.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Vihet re një kujdes i lartë i Gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore Unifikues, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, duhet të vlerësohet “Shume Lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga Gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuar, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa, thonjëza), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.¹¹²

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare (me objekt zgjidhje martesë), evidentohet kujdesi i Gjyqtarit për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve nga palët, në respektim të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.¹¹³

¹¹² P.sh: *prima facie*, “*ad processum*”, “*ex officio*”, “*a contrario*”. Përdor termin latinisht “*Conditio sine qua non*” dhe jep shpjegimin në kllapa: (kusht pa të cilin). “*omnis probandi incumbit actori*”, “*ad processum*”. Përmend termat latinisht “*res judicata*”, “*ad processum*, etj.

¹¹³ Vendim nr. 43 date 17.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezultojnë përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezultojnë se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuara në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se Gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezultojnë se:

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, së cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe atyre thelbësore, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje, përgjithësisht të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prania ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe akuza ose objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, të cilat kryesisht janë të listuar formalisht me tituj, duke orientuar qartë lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje: I. Procedura; II. Rrethanat e faktit. III. Pretendimet e palëve. IV. Vlerësimi i Gjykatës, ku merret në analizë ligji zbatueshëm dhe aplikimi i tij në faktet konkrete të çështjes lidhur me objektin e padisë/kërkesës apo në çështjet penale me secilën akuzë të ngritur nga prokuroria, lidhur me caktimin e masës së dënimit (për secilin të pandehur), lidhur me provat materiale, për sa i përket fakteve penale/civile të konstatuara gjatë gjykimit nga persona të tjerë dhe lidhur me shpenzimet gjyqësore.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim disponimi i gjykatës mbi padinë e ngritur, ai në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet, mënyra e disponimit për çështjet specifike të seancës paraprake (*për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal*), caktimin e llojit të dënimit, masën e tij duke aplikuar uljen, momentin e fillimit të ekzekutimit të dënimit, disponimi mbi provat materiale dhe masat e sigurimit, aplikimi i alternativave të dënimit duke përcaktuar kohëzgjatjen konkrete, si dhe kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet në dispozitiv e drejta e ankimit, gjykata kompetente, dhe afati i ushtrimit të saj.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale të themelit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “shume e larte”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezultojnë një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake; procedimit me gjykim të shkurtuar, etj.

Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Pasi dispozita zërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, ajo vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes. Gjyqtari tregon kujdes në arsyetim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtari kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari i kushton rëndësi evidentimit dhe plotësimin me argumente të marrëdhënies shkak-pasojë, në përjashtjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezultojnë e nevojshme, p.sh:

- Interpreton institutin e dënimit, i cili ka për qëllim parandalimin e përgjithshëm, edukimin e shtetasve dhe parandalimin e posaçëm, i cili ka të bëjë me autorin e veprës penale dhe që synon edukimin e tij¹¹⁴

¹¹⁴ vendimi nr. 128 date 05.07.2022, vendimin nr. 43, datë 17.03.2021; nr.82 date 28.07.2020 ; vendimin nr. 177, datë 13.10.2020 ;vendimin nr. 49, datë 20.01.2022 ;vendimin nr. 81, datë 16.07.2020, vendimin nr. 227, datë 15.12.2022,)

- Interpreton institutin e parashkrimit të ndjekjes penale, duke cituar nenin 66 të Kodit Penal, dhe arsyeton se qëllimi i ligjvënësit ka qenë realizimi në praktikë i efektit të përgjithshëm dhe të veçantë, parandalues të dënimit në çdo rast konkret dhe disiplinimi i fazës së hetimeve paraprake e përfundimi i tyre nga prokuroria në një periudhë sa më të shpejtë.¹¹⁵
- Trajton institutin e arrestimit në flagrancë si një kufizim i përkohshëm i lirisë së personit në kompetencë gjyqësore, përmes interpretimit literal dhe qëllimor të nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale. Interpretimi i nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, mbështetet nga interpretimi sistematik i neneve kushtetuese dhe konventore, neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5 gërma c e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas të cilëve, arrestimi në flagrancë kryhet me qëllim që personi t'i dërgohet një autoriteti gjyqësor kompetent, i cili më pas bën vlerësimin nëse është i ligjshëm arrestimi apo ndalimi.¹¹⁶
- Trajton institutin e masave të sigurimit si një kufizim i përkohshëm i të drejtave dhe lirive të personit të dyshuar për kryerjen e veprës penale, i dhënë me vendim të gjykatës; jo masa ndëshkimore, por të nevojshme për procesin e hetimit (grumbullimin e provave).¹¹⁷
- Trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit me kusht zbatimin e provës, duke përcaktuar se funksioni kryesor i tij është nevoja e individualizimit dhe caktimit të dënimit e mundësisë së riedukimit duke e pezulluar dënimin për një periudhë mbikëqyrje të caktuar¹¹⁸.
- Trajton institutin e gjësë së gjykuar (res iudicata) sa i përket vendimmarrjes së ish komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave në rast se ndaj tij nuk ushtrohet ankim, duke e bërë atë përfundimtar, të pamundur për t'u ngritur sërish e njëjta padi/kërkesë, me të njëjtat palë, të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak juridik. Ky institut trajtohet në lidhje me parimin e sigurisë juridike si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës, që përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normative, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore¹¹⁹
- Institutit të zgjidhjes së martesës, format e zgjidhjes së saj, duke u ndaluar në mënyrë më të detajuar në analizën e rastit konkret, atë me pëlqim reciprok të palëve. Po ashtu ndalet në trajtimin e pasojave ligjore që rrjedhin nga zgjidhja e martesës lidhur me: lënien e fëmijës për rritje dhe edukim; detyrimin për ushqim, si dhe të drejtën e takimit për prindin tjetër, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës¹²⁰

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e Gjyqtarit është paraqitja dhe analiza e detajuar e fakteve të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet dhe autorësinë e saj. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë. Gjyqtari integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve

¹¹⁵ Vendimin nr. 99, datë 20.05.2021

¹¹⁶ vendimin nr. 38 datë 15.03.2020

¹¹⁷ Po aty

¹¹⁸ Vendimin nr. 158, datë 28.10.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

¹¹⁹ Vendimi nr. 368, datë 27.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

¹²⁰ Vendimin nr. 36, datë 10.02.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, r vendimin nr. 295, datë 01.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër , vendimin nr. 18 datë 27.01.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ;vendimin nr. 193, datë 27.07.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural. Gjyqtari ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit apo faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake.

Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, kryesisht në drejtim të: figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet dhe elementëve e saj, si dhe autorësisë e të pandehurit;¹²¹ ecurisë procedurale të gjykimit në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar; analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të individualizimit të dënimit;¹²² aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke analizuar kriteret ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për aplikimin e kësaj alternative.¹²³

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.*). Pretendimet e palëve merren gjithmonë në shqyrtim dhe analizohen në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre. Ato integrohen natyrshëm në arsyetimin tërësor të vendimit gjyqësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se Gjyqtari ka aftësi shume të mira në lidhje me treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik në mënyrë të organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë zbatim. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtrura për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

¹²¹ Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, Gjyqtari ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përjasjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet

¹²² Në të gjitha vendimet penale të themelit.

¹²³ Vendim nr.158, datë 28.10.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shume e larte”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Nivelin i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkelqyeshem

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e Gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e Gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë 388 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, nga të cilat 81 çështje ose 20.8% e tyre kanë përfunduar tej këtij afati.

Pavarësisht këtij raporti të pasqyruar në Raportin Analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësim, referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër¹²⁴dhe shpjegimeve të Gjyqtarit në formularin e vetëvlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka gjykuar gjithsej 81 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi (37 çështje në vitin 2020, 31 çështje në vitin 2021 dhe 13 çështje në vitin 2022), të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Penale seancë parapake” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë”.

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (81 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (388 çështje), Gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 20.8 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

¹²⁴Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit 2020-2022 janë ridërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nëpërmjet postës elektronike në datën 16.06.2023.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin Ombi mesatare, duke argumentuar si vijon: *“Vlerësoj se kam respektuar këtë kriter në nivelin “Mbi mesataren”.* Për vitin 2020 ky raport është 44/210 ose 20.9%, për vitin 2021 raporti është 30/167 ose 17.9% dhe për vitin 2022 raporti është 7/130 ose 5%. Nga kjo rezulton se mesatarja e çështjeve në tejkalim të afatit ligjor është 14.6%. Referuar dispozitave të K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale çështje të cilat parashikojnë afate ligjore janë: kundërshtimi i veprimeve përmbartimore, sigurimi i padisë, urdhri i mbrojtjes dhe urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, masat e sigurimit, vendimet e përgjimit, kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, vendimi për ankimin ndaj mosfillimit të procedimit, gjykimi në seancë paraprake, njohja e vendimit penal, shuarja e masës së sigurimit dhe miratimi i urdhrin penal. Ky parametër nuk është në nivelin *“Shumë e lartë, kryesisht për shkak të mosrealizimit të gjykimeve penale në seancë paraprake brenda afatit ligjor 30 ditor.* Për vitin 2020 gjykimet jashtë afatit në këtë kategori janë 52%, për vitin 2021 është 31.7% dhe për vitin 2022 është 5.8%. Mosrespektimi i këtij afati gjykimi për vitin 2020 kryesisht ka ardhur për shkak të shtyrjeve të seancave si rrjedhojë e mosrealizimit të njoftimeve nga shërbimi postar, pasaktësisë së adresave të subjekteve procedurale, si dhe nga pandemia COVID-19.”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se gjyqtari ka përmbushur këtë kriter në nivelin *“Mbi mesataren”.*

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për secilën prej çështjeve që ka rezultuar jashtë afatit ligjor nese marrim parasysh pandeminë e COVID 19 nga data 10.03.2020 deri në datën 27.04.2020; leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalendarike për gjyqtarët) - festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë, atëherë gjyqtari rezulton te ketë shqyrtuar 30 çështje me pak se çfarë ka konkluduar raporti analitik pra 61 çështje në tejkalim të afatit ligjor. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 81 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se :

1. Çështjet me objekt Në tabelën nr.10, çështja me nr. rendor 68, me objekt *“Zëvendësim/Revokim mase sigurimi”*, e cila është gjykuar në afatin 6 ditë, 1 ditë në tejkalim të afati referuar paragrafit 4 të nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.
2. Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 70, me objekt *“Zëvendësim mase sigurimi”*, e cila është gjykuar në afatin 7 ditë, 2 ditë në tejkalim te afatit te parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.
3. Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 77, me objekt *“Zëvendësim mase sigurimi”*, e cila është gjykuar në afatin 6 ditë, ndërkohë që referuar paragrafit 4 të nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë, një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.

4. Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 83, me objekt “*Revokim mase sigurimi*”, e cila është gjykuar në afatin 7 ditë, 2 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar nga paragrafi 4 i nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë, një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.
5. Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 16, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 32 ditë, 2 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.
6. Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 56, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 61 ditë, 31 ditë të tejkalim të afatit ligjor të parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Por nëse nga ky afat zbrësim periudhën e pushimeve vjetore të muajit gusht për gjyqësorin (*gjithsej 35dite*) kjo çështje rezultoi e përfunduar në një afat prej 25 ditësh dhe konsiderohet e përfunduar brenda afati ligjor prej 30 ditësh .
7. Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 59, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 51 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Por nëse nga ky afat zbrësim periudhën e pushimeve vjetore të muajit gusht për gjyqësorin (*gjithsej 35 dite*) kjo çështje rezultoi e përfunduar në një afat prej 16 ditësh dhe konsiderohet e përfunduar brenda afati ligjor prej 30 ditësh .

Për vitin 2021 kanë rezultuar si me poshtë :

1. Në tabelën nr.1, çështja me nr. rendor 26, me objekt “*Kundërshtim veprimi përmbarrimor*”, e cila është gjykuar në afatin 22 ditë, 2 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar nga neni 610 të K.Pr.Civile në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezultoi afati ligjor 20 ditë, një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.
2. Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 2, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”¹²⁵, është rregjistruar me datë 07.12.2020 dhe ka përfunduar me date

¹²⁵ Me ndryshimet e Ligjit nr. 41/2021 është parashikuar në shkronjën « c » të nenit 332/dh të K.Pr.Penale se : « ... 1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare **kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar**, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit; » Duke qenë se në tabelën statistikore janë përlllogaritur si jashtë afatit të gjitha çështjet me objekt « Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq » në rast se kanë tejkaluar 30 ditë, në pamundësi për të verifikuar datën se kur është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, pasi Gjyqtari i Seancës Paraprake për shkak të ligjit, kur ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar është bërë gjyqtar kompetent për gjykimin në themel të çështjes, analiza do të bëhet referuar të dhënave statistikore, por çështjet që kanë shënimin « Dërgim i çështjes në gjyq TH » do të përlllogariten në tabelën nr. 8 e cila përmban krimet. Për rrjedhojë, do të zbriten nga çështjet me afat ligjor dhe do të analizohen si çështje me afat standard minimal.

26.01.2021 është gjykuar në afatin 40 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Nëse marrim parasysh festat e fundvitit dhe afatin e mbartjes së dosjeve 6 ditë atëherë çështja ka përfunduar në afatin 34 ditë, me 4 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar ligjore çka përben një tejkalim të papërfillshëm të afatit ligjor.

3. Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 16, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 33 ditë, 3 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar nga 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë, një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor.

Për vitin 2022,

1. Në tabelën nr. 3, çështja me nr. rendor 73, me objekt “*Lëshim urdhëri i mbrojtjes*”, e cila është gjykuar në afatin 19 ditë, - 4 ditë në tejkalim të afatit të parashikuar, nga paragrafi i parë i nenit 16 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, ka parashikuar afatin ligjor 15 ditë. Çështja është regjistruar me datë 29.09.2022 dhe ka përfunduar me datë 18.10.2022. Nëse përjashtojmë datat 01-02-shtunë e diele, atëherë kemi të bëjmë me një tejkalim të papërfillshëm të afatit ligjor.
2. Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 45, dhe me nr. rendor 50, me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 7 ditë dhe 6 ditë, në tejkalim me 1-2 ditë të afatit ligjor çka përben një tejkalim të papërfillshëm të këtij afati i cili referuar paragrafit 4 të nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezultojnë 5 ditë. Çështja me nr. rendor 45 është regjistruar me datë 08.03.2022 dhe ka përfunduar me datë 15.03.2022, (nëse zbrisim datat 12-13.03.2022 shtunë e diele dhe 14 Mars feste zyrtare atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar në një afat prej 4 ditësh .

Sa më sipër, në total nga 81 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e sipërcituara 13 çështje), rezultojnë që Gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 68 çështje ose rreth 17.5% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësimit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga treguesi të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, rezultojnë se Gjyqtari ka pasur një ngarkesë të lartë çështjesh në periudhën e vlerësimit pasi në total ka gjykuar 1366 çështje, nga të cilat 807 çështje me palë kundërshtare.

Kështu, nga tabela nr. 11 e vitit 2021 nuk do të përllogariten si çështje të seancës paraprake me afat ligjor, çështjet me nr. Rendor 53, 54, 67, 74, 75, 76, 77, 78, 81, 82, 85, 86, 88, 90, 96,97,98.

KONKLUZIONI

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Për pikëzimin në rastin konkret duke pasur në konsideratë:

- i) ngarkesën e lartë të Gjyqtarit, referuar faktit se për periudhën e vlerësimit;
- ii) vetëvlerësimin e Gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii) numrin e lartë të çështjeve me afat ligjor, 388 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 28.4 % të çështjeve të shqyrtuara prej tij në periudhën e vlerësimit; vlerësoj se Gjyqtari duhet të pikëzohet për këtë tregues me nivelin maksimal prej 15 pikesh.

Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues Gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi justifikohet përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor prej 17.5% me numrin e lartë të çështjeve të gjykuara prej 1366 çështje në total.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se Gjyqtari ka gjykuar gjithsej 998 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (107 çështje në vitin 2020, 64 çështje në vitin 2021 dhe 31 çështje në vitin 2022), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Marrëdhënie pune”, “Penalë krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprahe-kërkesa për pushimin e procedimit penal” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se nga **998** çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal

kohor, **202**¹²⁶ prej tyre janë gjykuar tej këtij afati duke përbërë **20.2%** të çështjeve të gjykuara jashtë stand{...} minimal kohor në fuqi.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, pasqyruar edhe në raportin analitik, e ka vlerësuar treguesin “*Plotësimi i standardeve minimale kohore*” në shkallë mbi mesatarë . Konkretisht, është shprehur si vijon: “*Vlerësoj se kam respektuar këtë kriter në nivelin “Mbi mesataren” . Dua të theksoj se këtu duhet pasur parasysh ngarkesa ime si gjyqtar, mungesa e organikës së plotë me gjyqtarë për vitet 2020-2021, ndërprerja e gjykimeve për shkak të pandemisë COVID-19 për periudhën 10 Mars-1 Qershor 2020, shtyrjet e seancave për shkak të mos njoftimit të rregullt të subjekteve procedurale nga shërbimi postar, mungesa e adresave të sakta të palëve ndërgjyqëse, pezullimi i çështjeve penale deri në një vit për të pandehurit në mungesë, pezullimin e çështjeve civile, që varen nga një proces tjetër civil/penal. Nga të dhënat që disponoj, sipas përlllogaritjeve të mia, bazuar në të dhënat e marra nga Statistikat Vjetore te Kancelarisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër) kam arritur të përfundoj këtë numër çështjesh: për vitin 2020 ka qenë 526 çështje, për vitin 2021 ka qenë 386 çështje dhe për vitin 2022 ka qenë 361 çështje (civile dhe penale). Standardi minimal kohor të tejkaluara rezultojnë të jenë 26.2 % për vitin 2020, 17.1 % në vitin 2021 dhe 8 % në vitin 2022. Pra mesatarja ne tejkalim te stand{...} minimal kohor është 17.1%. Nëse do të merret parasysh se një numër i konsiderueshëm çështjes penale kanë qenë të pezulluara deri në një vit dhe konkretisht 23 çështje, tejkalimi i afateve ligjore do të ishte akoma më i ulët. ” Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “ në nivelin “Mbi mesataren” . Duhet të mbahet parasysh me të drejtë ngarkesa e gjyqtarit me çështje, zvarritjet e shkaktuara për shkak të pandemisë COVID-19, mungesa e adresave të sakta të palëve. moskryerjen e njoftimit të rregullt nga shërbimi postar. ”*

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 53 çështjet e shqyrtuara jashtë stand{...} minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga Gjyqtari (*muaj gusht i vitit 2020, vitit 2021 dhe viti 2022*), si dhe periudha e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore prej 1 muaj e 17 ditë, për shkak të pandemisë së COVID 19¹²⁷. Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të

¹²⁶107 çështje në viti 2020, 64 çështje në viti 2021 dhe 31 në vitin 2022.

¹²⁷ Me Vendim Nr. 127, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-2019.” Me Vendim Nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-19...5. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë për një periudhë 2 (dy) javore duke filluar nga data 25.03.2020 deri me date 07.04.2020.” Me Vendim Nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-19. 5. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë për një periudhë 2 (dy) javore duke filluar nga data 08.04.2020 deri më datë 22.04.2020.” Me Vendimin Nr. 143, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore” Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, më datë 27.04.2020.” Pra, veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar nga data 10.03.2020 deri në datën 27.04.2020, për një periudhë prej 1 muaj e 17 ditë.

përfshihej periudha kur Gjyqtari ka qenë me leje vjetore dhe periudha e pezullimit, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

Për vitin 2020 rezulton se:

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 5, 6, 9, 11, 14, 17, 20 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 274 ditë, 232 ditë, 202 ditë, 257 ditë, 241 ditë, 221 ditë, 185 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj (180 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit zbresim periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), leje vjetore 35 si dhe festat e fund vitit dhe mbartje e dosjeve e llogaritur ne 6 ditë, atëherë çështje me nr. rendor 5 ka përfunduar në tejkalim te 6 ditëve nga 180 ditë te parashikuara nga ligji, ndërsa çështja me nr. rendor 6 do kishte përfunduar brenda 179 ditëve duke i zbritur periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), si dhe festat e fund viti ; për çështjen me nr. rendor 9 nëse zbresim ditët e periudhës se COVID 47 ditë, si dhe festat e fund vitit dhe mbartje e dosjeve e llogaritur ne 6 ditë rezulton 149 ditë kohëzgjatja e gjykimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatin standard minimal 6 muaj; për çështjen me nr. rendor 11 nëse zbresim periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), leje vjetore 35 rezulton 120 ditë kohëzgjatja e gjykimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatin standard minimal 6 muaj Për çështjen me nr. rendor 14 nëse zbresim gjithashtu periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), leje vjetore 35 rezulton 159 ditë kohëzgjatja e gjykimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatin standard minimal 6 muaj; për çështjen me nr. rendor 17 nëse zbresim gjithashtu periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), leje vjetore 35 rezulton 139 ditë kohëzgjatja e gjykimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatin standard minimal 6 muaj; për çështjen me nr. rendor 20 nëse zbresim leje vjetore 35 rezulton 150 ditë kohëzgjatja e gjykimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatin standard minimal 6 muaj .
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 3, 6, 9, 16, 20, 27, 49, 51, 52, 53, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet: 146 ditë, 174 ditë, 155 ditë, 135 ditë, 123 ditë, 160 ditë, 167 ditë, 161 ditë, 152 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e çështjeve të mësipërme zbresim periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), të gjitha çështjet konsiderohen të përfunduara përkatësisht 99 ditë, 127 ditë, 108 ditë, 88 ditë, 89 ditë, 3 ditë tejkalim i papërfillshëm i afatit, 113 ditë, 120 ditë, 114 ditë, 105 ditë të gjitha brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 3 dhe 9, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 64 ditë, 103 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për çështjen me nr. rendor 3 zbresim ditët e mbartjes se dosjeve 6 dite gjithsej dhe për nr. rendor 9 periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID

- 19 në vitin 2020 (47 ditë), atëherë të gjitha çështjet konsiderohen të përfunduara përkatësisht për 58 ditë dhe 56 ditë të gjitha brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr.7, çështjet me nr. rendor 7, 11, dhe 13 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 210 ditë, 216 ditë dhe 189 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj (180 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për secilën çështje zbresim ditët e mbajtjes se dosjeve 6 ditë gjithsej, periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), si dhe lejen vjetore per gjyqesorin, prej 35 ditësh, atëherë të gjitha çështjet konsiderohen të përfunduara përkatësisht për 122 ditë, 128 ditë, 101 ditë dhe 56 ditë të gjitha brenda afatit standard minimal.
 - Në tabelën nr. 8, çështjet me nr. rendor 50, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 333 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj (270 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për secilën çështje zbresim ditët e mbajtjes se dosjeve 6 ditë gjithsej, periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), si dhe lejen vjetore per gjyqesorin, prej 35 ditësh, atëherë konsiderohet e përfunduara 251 ditë brenda afatit standard minimal.
 - Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 1 dhe 8 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 145 ditë dhe 168 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për secilën çështje zbresim periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), atëherë konsiderohet të përfunduara për 98 ditë dhe 121 ditë brenda afatit standard minimal.
 - Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 28, 34¹²⁸, 35¹²⁹, 36¹³⁰ dhe 40¹³¹ të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 99 ditë, 84 ditë, 70 ditë, 72 ditë, 63 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për secilën çështje zbresim periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 në vitin 2020 (47 ditë), atëherë konsiderohet e përfunduara për 52 ditë, 61 ditë (1 ditë tejkalim i papërfillshëm), 47 ditë, 49 ditë, 59 ditë, brenda afatit standard minimal.
 - Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 10, dhe 12, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 92 ditë, 100 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit për secilën çështje zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, (muaji gusht 35 ditë), atëherë konsiderohet e përfunduar për 57 ditë, 65 brenda afatit standard minimal.

Për vitin 2021 rezulton se:

¹²⁸Ka date shorti 03.04.2021 peiudha e ngelur nga Covid-19 zbriten 23 ditë pasi mbaron me date 27.04.32021

¹²⁹Ka date shorti 03.04.2021 peiudha e ngelur nga Covid-19 zbriten 23 ditë pasi mbaron me date 27.04.32021

¹³⁰Ka date shorti 03.04.2021 peiudha e ngelur nga Covid-19 zbriten 23 ditë pasi mbaron me date 27.04.32021.

¹³¹Ka date shorti 23.04.2021 peiudha e ngelur nga Covid-19 zbriten 3 ditë pasi mbaron me date 27.04.2021.

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 16, 21, dhe 22, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 216 ditë, 183 ditë, 183 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj (180 ditë). Duke zbritur lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gusht 35 ditë , atëherë këto çështje konsiderohen përkatësisht te përfunduara brenda 181 me 1 ditë tejkallim te papërfillshëm, 148 ditë dhe 148 ditë , brenda stand{...} minimal te parashikuar.
- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 4,8,17, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 69 ditë, 64 ditë me 4 ditë tejkallim te papërfillshëm, 64 ditë me 4 ditë tejkallim te papërfillshëm. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Këto çështje konsiderohen te përfunduara brenda afatit pasi duke zbritur festat e fund vitit dhe mbartjen e dosjeve (gjithsej 6 ditë) nga kohëzgjatja e gjykimit rezulton qe kane përfunduar përkatësisht për 63 ditë, 60 ditë.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 2, 22, dhe 48 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet: 129 ditë, 127 ditë, dhe 127 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gush 35 dite dhe festat e fund vitit për dy çështjet e tjera nr. rendor 129, 127 gjithsej 6 ditë, këto çështje konsiderohen te përfunduara brenda afatit, me kohëzgjatje gjykimi përkatësisht 122 ditë me 2 ditë tejkallim të papërfillshëm, 123 ditë me 3 ditë tejkallim të papërfillshëm, 92 ditë.
- Në tabelën nr. 4, çështjen me nr. rendor 5, e gjykuar në afatin 83 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gusht 35 ditë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit, me kohëzgjatje gjykimi 48 ditë.
- Në tabelën nr. 8, çështjet me nr. rendor 15 dhe 56, të cilat janë gjykuar, përkatësisht në afatin 279 ditë dhe 280 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj (270 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gush 35 ditë këto çështje konsiderohen të përfunduara brenda afatit, me kohëzgjatje gjykimi 245 ditë dhe 244 ditë.
- Në tabelën nr. 11, çështje me nr. rendor 66, e gjykuar në afatin 64 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gush 35 ditë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit, me kohëzgjatje gjykimi 29 ditë.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 21 dhe 22, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 85 ditë dhe 63 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gush 35 ditë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit, me kohëzgjatje gjykimi 50, 28 ditë.

Për vitin 2022 rezulton se:

- Në tabelën nr. 1, çështjen me nr. rendor 5, e gjykuar në afatin 185 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj (180 ditë). Siç shihet kohëzgjatja e çështjes është 5 dite tej afatit çka do të thotë se kemi të bëjmë me një tejkallim te papërfillshëm .
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 39,47, dhe 51, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet: 140 ditë, 133 ditë, dhe 471 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gusht gjithsej 35 ditë si dhe periudhën atëherë këto çështje kane përfunduar brenda afatit përkatësisht për 105 ditë, 98 ditë dhe 35 ditë. Për çështjen me nr. rendor 51 ka një lapsus ne tabelën statistikore pasi çështja është shortuar me datë 04.10.2022 dhe ka përfunduar me datë 08.11.2022 me kohëzgjatje gjykimi prej 35 ditësh , e cila pasqyrohet gabimisht ne tebele me afat 471 ditë.
- Në tabelën nr. 4, çështjen me nr. rendor 5, e gjykuar në afatin 82 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj (60 ditë). Nëse zbresim lejen vjetore per gjyqesorin, muaji gusht gjithsej 35 ditë atëherë kjo çështje ka përfunduar brenda afatit prej 47 ditë.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 4, gjykuar në afatin 462 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë). Nëse zbresim periudhën gjate se cilës çështja ka qene e pezulluar 1(vit) atëherë këto çështje kane përfunduar brenda afatit përkatësisht për 98 ditë

Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë stand{...} minimal kohor, do të përjashtoheshin 52 çështjet e analizuar më sipër, për të cilat, nëse do të zbritet periudha e lejes vjetore, periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, rezultojnë të përfunduara brenda afatit apo ky afat rezulton i tejkalluar me vetëm 1 deri në 7 ditë (i papërfillshëm). Bazuar në analizën e mësipërme rezulton se nga **998 çështje të përfunduara** gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 149 prej tyre ose rreth **14.9% janë gjykuar jashtë stand{...}** minimal kohor në fuqi, i cili sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë, por duke marre parasysh sa me sipër treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022, ku Gjyqtari ka përfunduar 1366 çështje, nga të cilat 807 çështje me palë kundërshtare ¹³²vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht për këtë tregues.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me :

- a) raportit të çështjeve të gjykuara tej afatit standard, me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet ky afat, i cili rezulton të jetë në masën 15%
- b) vetëvlerësimin e Gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

¹³²Në pikën 3 shkronja "h" të "Kritereve matëse të veprimtarisë së gjyqësore", miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **h. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.**

- c) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022, ku rezulton se Gjyqtari ka përfunduar 1366 çështje, nga të cilat 807 çështje me palë kundërshtare;¹³³
- d) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore;
- e) ngarkesën e lartë të Gjyqtarit

pavarësisht përqindjes së mësipërme, vlerësoj se për këtë tregues, Gjyqtari duhet të pikëzohet nivelin e pikëzimit sipas Metodologjisë, me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e Gjyqtarit për treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht:

1. Në lidhje me çështjet e kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë **186.46** ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh.
2. Në lidhje me çështjet e kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 37.89 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh.
3. Në lidhje me çështjet e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 94.32 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
4. Në lidhje me çështjet e kategorisë “familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 78.1 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
5. Në lidhje me çështjet e kategorisë “marrëdhënie pune”, koha mesatare rezulton të jetë 117.38 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
6. Në lidhje me çështjet e kategorisë “krime”, koha mesatare rezulton të jetë 97.78 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 9 nëntë dhe dymbëdhjetë muajsh.
7. Në lidhje me çështjet e kategorisë “kundërvajtje”, koha mesatare rezulton të jetë 98.9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 (katër) muajsh.
8. Në lidhje me çështjet e kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, koha mesatare

¹³³Në pikën 3 shkronja “h” të “Kritereve matëse të veprimtari së gjyqësore”, miratuar me vendimin e KLD nr.261/2 të vitit 2010, lidhur me Standardi sasior i punës parashikohet: **h. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.**

rezulton të jetë 9 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

9. Në lidhje me çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 35.88 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
10. Në lidhje me çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 66.32 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin në shkallë mbi mesatarë.

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: *“Në të gjitha çështjet tejkalmi i afateve ligjore nuk ka qene për neglizhencën ose paaftësinë për të menaxhuar një proces gjyqësor, pasi në çdo rast nga ana e gjyqtarit janë marrë masat e nevojshme që seancat e caktuara të mos shtyhen për shkaqe të pa bazuara në ligj.”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 3 nga 10 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për 3 nga kategoritë e çështjeve “*Familjare pa palë kundërshtare, 78.1 ditë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”184.6” ditë, dhe “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit të marrëdhëniet juridiksionale me jashtë”66.3*, duke u tejkualuar ky afat respektivisht me 18.1 ditë, 4.6 ditë dhe 6.3 ditë, tejkalime të cilat mund të konsiderohen të papërfillshme duke marrë konsiderate faktin që gjyqtari ka gjykuar një numër shume të madh çështjesh nga çfarë i janë caktuar konkretisht 1366 të përfunduara nga 1057 të caktuara dhe aq me shume kur në një kohë kishte pezullim të veprimtarisë gjyqësore siç kanë qene periudha e izolimit të COVID 19 gjatë vitit 2020. Vlerësoj se për këtë tregues Gjyqtari, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabarte me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2020-31.12.2022) gjyqtari {...} ka përfunduar 1385 çështje gjyqësore ndërkohë që i janë caktuar për gjykim

1057 të tilla. Rrjedhimisht, rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore për subjektin e vlerësimit për periudhën rezulton të jetë 131%.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë mesatare . Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Mendoj se këtë kriter e kam përmbushur në nivelin “Mesatar”. Sipas përlllogaritjeve të mia, bazuar në të dhënat e marra nga Statistikat e Kancelarisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër) për vitin 2020 ky raport është 482/565 ose 85.3 %; për vitin 2021 raporti është 386/416 ose 92.7 %; për vitin 2022 raporti është 361/390 ose 92.5 % dhe mesatarja e të tre viteve rezulton 90.3 %. Dëshiroj të nënvizoj se pjesa dërrmuese e çështjeve të mbartura janë çështje penale të pezulluara për shkak të mosgjetyes së të pandehurit, që konform nenit 350/1 të K.Pr.Penale pezullohen deri në 1 vit. Kështu rezultojnë të pezulluara mbështetur në këtë dispozitë 4 çështje penale për vitin 2020, 10 çështje penale për vitin 2021 dhe 7 çështje penale për vitin 2022. Disa prej çështjeve të pezulluara të vitit 2020 janë çështje që janë rishortuar pas lejes së gjyqtarëve të tjerë. Gjithashtu për vitin 2020 duhet të mbahet parasysh se gjykimet kanë qenë të pezulluara me vendim të KLGJ-së për periudhën tremujore Mars 2020-Qershor 2020 për shkak të pandemisë COVID-19.”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “Gjyqtari {...} ka plotësuar këtë kriter në nivelin “Mesatar”. Në vlerësimin tim, në llogaritjen e rendimentit duhet të merren në konsideratë edhe një sërë arsyesh objektive si: i) kompleksiteti i çështjeve të gjykuara;ii) praktika e prokurorisë ku në ditët e fundit të vitit depoziton dhe nga ana e administratës gjyqësore regjistrohen një numër i madh çështjesh, në krahasim me periudhat e mëparshme;ii) fakti që në dy javët e para të muajit janar, për shkak të rimumërtimit dhe mbartjes së dosjeve gjyqësore, nuk kryhen veprime në sistem. Kështu, çështjet e regjistruara në ditët e fundit të vitit, krijojnë një rritje të menjëhershme të numrit të çështjeve të regjistruara, të cilat nga ana tjetër, nuk mund të gjykohen brenda këtij viti (për shkak të kohës së mbetur), duke krijuar kështu një rezultat fiktiv negativ në përlllogaritjen e efijçencës në punë.”

Sipas pikës 3 shkronja “g”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale themeli dhe çështjes civile me palë kundërshtare.

Në total për të gjithë periudhën e vlerësimit, Gjyqtari ka përfunduar 1366 çështje në total për periudhën për të cilën vlerësohet, nga të cilat 807 çështje me palë kundërshtare, konkretisht 326 çështje në vitin 2020 me një rendiment 163 %, 271 çështje në vitin 2021 me një rendiment 135.5 % dhe 210 çështje në vitin 2022. me një rendiment 105 % Pra, Gjyqtari ka arritur të përfundojë 134.5% të çështjeve me palë kundërshtare, nga standardi i vendosur, përgjatë gjithë periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i Gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 134.5% si i tille duhet pikëzuar me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e Gjyqtarit për këtë tregues duhet të pikëzohet me të njëjtin nivel pikëzimi sipas Metodologjisë së Pikëzimit, i cili përkon me rendimentin në masën 134% duke u pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

1. Për çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 20.38 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
2. Për çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 10.27 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
3. Për çështje të kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 15.88 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
4. Për çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 14 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
5. Për çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 34.23 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
6. Për çështje të kategorisë *“krime”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 21.67 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
7. Për çështje të kategorisë *“kundërvajtje”*, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 12.22 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
8. Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”* koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- (i) Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi¹³⁴, 8.9 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.
- (ii) Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 7.25 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
- (iii) Për kërkesa me objekt “Shuarje mase”, 5.1 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 261/3 dhe 248/2 i K. Pr. Penale.
- (iv) Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, lejim kontrolli, 2.35 ditë, pra më e gjatë¹³⁵ se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
- (v) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit “Deklarim i ikjes”, (neni 247 i K.Pr.Penale) 1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- (vi) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit”, (neni 291 i K.Pr.Penale) 13.92 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

9. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprahe*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 10.43 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.

- (i) Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 20.98 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

10. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- (i) Për kërkesa me objekt “*Përjashtimin e gjyqtarit*” (pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K. Pr. Penale me ligjin nr. 35/2017), koha mesatare e arsyetimit është 4.6 ditë, pra më e gjatë sesa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K. Pr. Penale.
- (ii) Për kërkesa me objekt “*Rivendosje në afat ankimi*”, koha mesatare e arsyetimit është 1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga neni

¹³⁴ Përsa i përket kërkesave me objekt “Caktim mase sigurimi” të cilat merren në mungesë dhe janë të natyrës sekrete, nga tabelat statistikore rezultojnë se datat e depozitimit të vendimeve të arsyetuara janë ato që pasqyrohen.

¹³⁵ Përlllogaritja është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore, ku si datë depozitimi vendimi është marrë data që Gjyqtari ka depozituar vendimin e arsyetuar në sekretari. Nga përmbajtja e të dhënave statistikore rezultojnë se shqyrtimi i kërkesave për lejim përgjimi është bërë brenda 24 orëve, por këto kërkesa kanë karakter sekret. Vetëm kërkesa me objekt lejim kontrolli me nr. Rendor 83 në tabelën nr. 10 të vitit 2020 rezultojnë të jetë shqyrtuar 1 muaj pas regjistrimit të kërkesës dhe vendimi është dorëzuar i arsyetuar 6 ditë pasi është shpallur.

420/1 i K.Pr.Penale.

- (iii) Për kërkesa me objekt “*Shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të dënimit*”, koha mesatare e arsyetimit është 4.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga neni 476 i K.Pr.Penale.
- (iv) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 10.31 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin “*Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor*” në shkallë Mbi mesatare (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “*Mendoj se për këtë tregues niveli është mbi mesataren. Nga përlllogaritja e bërë në bazë të të dhënave të marra nga Statistikat e Gjykatës së Dibrës rezulton se arsyetimi i vendimeve në afat është për vitin 2020 raporti 340/526 ose 64%; për vitin 2021 është 288/403 ose 71% dhe për vitin 2020 raporti është 306/361 ose 84 %. Mesatarja e të tre viteve është 73%. Theksoj se në këtë përlllogaritje janë përfshirë 24 çështje që në statistikë janë raportuar si të dorëzuara jashtë afatit për arsyetimet, ndërkohë që afati për to përfundonte në muajin Gusht, që duke qenë pushim vjetor me ligj për të gjithë gjyqtarët, nuk duhet të merrej në konsideratë. Për rrjedhojë këto vendime konsiderohen të arsyetuara në afat. Rendimenti ka qenë më i ulët për vitin 2020, pasi ngarkesa ka qenë shumë më e madhe se vitet pasuese. Po ashtu ka ndikuar mbingarkesa e krijuar nga pandemia COVID-19 për periudhën e sipërcituar, për shkak të së cilës është ndërprerë për disa muaj veprimtaria gjyqësore.*”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “*Vlerësoj se gjyqtari {...} ka përmbushur këtë kriter në nivelin “Mbi mesatar”.*”

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, *analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.*

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se: Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, tejkalimi i afatit procedural është me 0.38 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë; për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, tejkalimi i afatit është me 0.2 ditë, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm; për çështje të kategorisë «*marrëdhënie pune*» tejkalimi i afatit procedural 14.23 ditë, një tregues që kalon një ditë të plotë dhe si i tillë duhet të mbahet në konsideratë; për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi¹³⁶, tejkalimi i afatit procedural me 3.9 ditë, një tregues që kalon një ditë të plotë dhe si i tillë duhet të mbahet në konsideratë ; për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi,

¹³⁶ Përsa i përket kërkesave me objekt “Caktim mase sigurimi” të cilat merren në mungesë dhe janë të natyrës sekrete, nga tabelat statistikore rezultojnë se datat e depozitimit të vendimeve të arsyetuara janë ato që pasqyrohen.

tejkalimi i afatit procedural me 2.2 ditë, një tregues që kalon një ditë të plotë dhe si i tillë duhet të mbahet në konsideratë; për kërkesa me objekt “Shuarje mase”, tejkalimi i afatit procedural 0.1 ditor, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë; Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, tejkalimi i afatit procedural 0.43 ditor, një tregues i papërfillshëm dhe i pakonsiderueshëm në një ditë të plotë ; për kërkesa me objekt “Përrjashtimin e gjyqtarit” (pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K. Pr. Penale me ligjin nr. 35/2017 tejkalimi i afatit procedural me 2.6 ditë, një tregues që kalon një ditë të plotë dhe si i tillë duhet të mbahet në konsideratë.

Sa më sipër duhet të kemi parasysh se gjyqtari ka shqyrtuar një numër shume të madh çështjes 1366 çështje nga 1057 të caktuara dhe me një rendiment 131 % . Gjithashtu duke marrë parasysh shpjegimet e gjyqtarit ne formularin e vetëvlerësimit i cili shpjegon se një numër çështjes që kane ndikuar ne mesataren e llogaritur për arsyetimin e vendimit janë çështje të cilave afati i arsyetimit u mbaronte ne muajin gusht dhe duke qenë leje vjetore ku gjyqtaret dhe administrata gjyqësore janë pushim atëherë dorëzimi i këtyre dosjeve është bërë në muajin vijues.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton si “*Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*”, qe sipas Metodologjisë duke marrë parasysh gjithashtu nga sa u citua me lart justifikojnë në rastin konkret zbatimin e një niveli më të lartë pikëzimi bazuar në koeficientin 20%, me pasojë pikëzimin me 15 pikë, pasi gjithashtu për disa nga nënkategoritë çështjeve të sipërcituara rezulton që afati procedural të jetë tejkaluar me nga 0.1 ditë, 0.2 ditë, 0.3 ditë dhe 0.4 ditë pasur në konsideratë numrin e vendimeve të Gjyqtarit për arsyetim, e bën këtë afat të cenuar të papërfillshëm për tu marrë në konsideratë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” Gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh,¹³⁷ duke përrjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

¹³⁷Referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Kavajë, rezulton se nuk është gjeneruar numri i seancave gjyqësore për të gjitha çështjet. Për pasojë, referuar Metodologjisë së Pikëzimit”, numri

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 2 seanca;
- (ii) për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 2.6 seanca;
- (iii) për kategorinë “Penale themeli” është 1.8 seanca;
- (iv) për kategorinë “Penale seancë paraprake” është 3 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë 2.3 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se Gjyqtari në përgjithësi ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe si rregull janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se Gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë gjyqësore, pas ezaurimit të veprimeve përgatitore në çështjet civile dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, vendim për caktimin e seancës paraprake*), duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *për njoftimin e të pandehurit me anë të shërbimeve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë; për t'i dhënë kohë mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët për pajisjen me akt të vlefshëm përfaqësimi; për plotësimin e të metave të prokurës, duke u përkthyer në gjuhën shqipe dhe mbrojtjen efektive të të pandehurit, për përsëritjen e njoftimit për viktimën; për njoftimin e viktimës me shpallje, për t'i dhënë kohë të pandehurit të pajiset me mjet të vlefshëm identifikimi; për njoftimin dhe shoqërimin e të pandehurit me anë të shërbimeve të komisarariatit të policisë; për mosparaqitje të prokurorit; për njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht, për mosparaqitje të arsyeshme të prokurores së çështjes; për ti dhënë kohë prokurores të përgatisë konkluzionet përfundimtare me shkrim; për ti dhënë kohë palës paditëse për të paraqitur prova në gjykim dhe për ti komunikuar palëve në mungesë kërkesën për shtimin e objektit të padisë; për t'i dhënë kohë personit të tretë për të rregulluar të metat e aktit të përfaqësimit, për përsëritjen e njoftimit për palët ndërgjyqëse; për shkaqe shëndetësore të gjyqtarit; për t'i dhënë kohë palës së paditur të rregullojë aktet e përfaqësimit; për njoftimin e ekspertës psikologe; për shkak të mosparaqitjes së ekspertës psikologe për arsye shëndetësore; për përgatitjen e aktit të ekspertimit psikologjik, për përsëritjen e njoftimit për të paditurin në seancë pajtimi; pezullimin e gjykimit të çështjes civile për një afat tre muaj; për shkaqe shëndetësore të palës paditëse, për përsëritjen e njoftimit për të paditurin me shpallje etj. Pra, në përgjithësi, shtyrjet e seancave gjyqësore*

kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e Gjyqtarit së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.3 seanca dhe gjyqtari {...} ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “*Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, aftësia e Gjyqtarit është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile Gjyqtari është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesë padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*). Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë Gjyqtari ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenin 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, Gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes për marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Nga ana tjetër evidentohet se Gjyqtari ka respektuar afatet procedurale për caktimin e seancës së parë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon të tilla. Konkretisht për çështjet me objekt

“Dërgim në gjyq”, neni 332 i K.Pr.Penale, pika 2 e tij ka përcaktuar se nga data e depozitimit të kërkesës, deri në datën e seancës gjyqësore nuk duhet të kalojë një afat më i gjatë se 10 ditë, ndërkohë evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, me objekt “Dërgimin në gjyq” seanca gjyqësore është caktuar brenda këtij afati ligjor.

Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas rritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas rritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit Gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa deri nga 1 deri në 13 minuta (të papërfillshme), dhe vetëm një seancë rezulton të kenë filluar me vonëse 39 minuta për të cilën nga gjyqtari është relatuar shkak i vonesës që ka qenë diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.¹³⁸

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor. Siç konstatohet gjyqtari ka respektuar të gjitha aspektet proceduralë të rëndësishme për zhvillimin e gjykimit dhe vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtari duhet të vlerësohet me aftësi “shumë të larta” duke u pikëzuar me 20 pikë.

¹³⁸Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të rritit të shqyrtimi

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga Gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*regjistri i veprimeve, kërkesëpadi, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo*

seancë, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare).

Ajo çfarë rezulton është se në dosjet burim vlerësimi nuk konstatohet që pas vendimit të caktimit të seancës të jetë administruar letra e të drejtave.

Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mos administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Edhe për këtë tregues gjyqtari {...} Mustafa, ka paraqitur kundërshtimet e tij duke parashtruar nder të tjera se: *"... Konstatohet se relatori për rubrikën "2C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes" ka propozuar vlerësimin me 8 pikë, me arsyetimin se nuk është administruar kopje me shkrim e aktit "Letëre të drejtave e të pandehurit" dhe Letër e të drejtave të viktimës" të parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K. Pr. Penale. Lidhur me të drejtat procedurale të të pandehurit, neni 34/a2 i K.Pr.Penale parashikon se: "Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat "a" "b", "c", "ç", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar". Mendoj se ligjvënësi me termin "organ procedues" ka nënkuptuar policinë gjyqësore dhe organin e prokurorisë gjatë hetimeve paraprake, duke përjashtuar kështu gjykatën. Po kështu, edhe në lidhje me viktimën neni 58/2 i K.Pr. Penale termi "organ procedues" nënkupton policinë gjyqësore dhe prokurorinë. Madje kjo dispozitë. Gjithsesi nga ana ime në çështjet penale, ku kam qenë kryesues i trupit gjykues, të drejtat procedurale u janë komunikuar palëve gojarisht në sallë, si për të pandehurin, ashtu edhe për Viktimën, fakt që mund të verifikohet lehtësisht në procesverbalet audio dhe me shkrim. Pra, vlerësimi për këtë kriter duhet të jetë me 10 (dhjetë) pikë)..."*

Këshilli, si dëgjoi relatorin, e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarit vlerësoi se nuk është rasti për të përcaktuar një pikëzim të ndryshëm për këtë tregues vlerësimi, nga ai i propozuar nga ana e relatores, pasi duke qënë një parashikim ligjor dhe mbi të gjitha _administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit duhej të ishte adminstruar në dosjen gjyqësore, pasi përbën një të dhënë që vlerësohet në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete por konstatohet mungesa e "Letrës të të drejtave" e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit për këtë tregues është “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për Gjyqtarin {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit vitet 2020-2022, referuar te dhënave të përcjella nga ILD ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur ankesat si më poshtë:

Ankues shoqëria Eurosig sh.a., i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 1315 prot., datë 24.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 7/1 prot., datë 31.01.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga subjekti "Eurosig" sh.a.", ka vendosur arkivimin e ankesës, me arsyetimin se, pretendimet e subjektit "Eurosig" sh.a, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit {...} , lidhur me dhënien e vendimit penal nr. 18 datë 07.02.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në thelb janë pretendime të cilat lidhen me mënyrën e hetimit, administrimit të provave, si dhe paraqitjes të akuzës për një veprë penale konkrete, ndaj personit që i atribuohet, nga ana e gjykatës respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi hetimor/gjyqësor, është atribut i pushtetit gjyqësor dhe kjo kompetencë e gjykatës nuk mund të zëvendësohet me hetimin

disiplinor, që mund të realizohet ndaj vendimmarrjes së gjykatës, që është i një natyre të ndryshme nga ajo e zgjidhjes në themel të çështjes. Referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mos respektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit ndaj vendimit gjyqësor. Rezulton se vendimi gjyqësor nr. 18 datë 07.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka marrë formë të prerë në datë 22.02.2020, ku nga ana e të pandehurit G.MERA (tashmë i dënuar) nuk është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasi ka qenë dakord me konkluzionet dhe qëndrimin përfundimtar që ka mbajtur Prokuroria dhe Gjykata.

Ankues z. A.B, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat e regjistruara me nr. 2896 prot., datë 21.06.2021, nr. 3168 prot., datë 12.07.2021, nr. 3168/1 prot, datë 14.07.2021. Pas verifikimit të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2901/1 prot., datë 10.02.2023 "Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të paraqitura nga shtetasi z. Artan Balla", ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi në përfundim, nga të dhënat e grumbulluara në funksion të verifikimit të ankesës, nuk rezultuan fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve {...} dhe N.K, me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për shkelje disiplinore...".

Ankues z. S.D, përfaqësuar nga av. M.D, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 3201 prot., datë 15.07.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 3201/3 prot., datë 19.10.2021, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Sahit Derti, i përfaqësuar nga av. Melvut Derti", ka vendosur arkivimin e ankesës. Pasi *gjithashtu nga shqyrtimi i kryer i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura nga ana e shtetasit Sahit Derti përfaqësuar nga av. Mevlut Derti konstatohet se sjellja apo veprimet e magjistratit {...} nuk janë të natyrës së tillë që të përbëjnë shkelje disiplinore sipas parashikimeve të bëra nga nenet 101, 102, 103 dhe 104 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*"

Ankues z. M.D, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 4367 prot., datë 13.12.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 1075 prot., datë 26.04.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga av. M.D, ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi ne thleb *janë pretendime të cilat lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore, vlerësimin të provave nga gjykata respektive si dhe zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor, është atribut i pushtetit gjyqësor...Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk mund të marrë atributet e një organi tjetër, sikundërse është gjykata, për të kontrolluar themelin e vendimmarrjes së gjykatës dhe as të vlerësojë ndryshe aktet nga sa i ka vlerësuar vetë gjykata në procesin gjyqësor dhe për sa i përket pretendimeve të ankuesit për kompromise me palën, nga ana e magjistratit, vlerësohet se janë pretendime në terma të përgjithshëm, të pashoqëruara me argumente dhe prova konkrete dhe nuk pasqyrojnë fakte apo indicje të besueshme të cilat të*

krijojnë dyshime të arsyeshme se magistrati ka kryer veprime që klasifikohen si shkelje disiplinore në kuptim të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar...".

Ankues z. Xhelal {...}, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 2426 prot., datë 18.05.2021. Ankesa ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar. Me Shkresën e Gjyqtarit subjekt vlerësimi, me nr. 1053 Prot., datë 16.02.2024 është depozituar në Zyrën e Protokollit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kopje e Shkresës nr. 1659/6 Prot., datë 27.12.2023 me anë të së cilës është njoftuar Gjyqtari mbi Vendimin nr. 1659/3 datë 27.12.2023 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi Xhelal {...}”. Gjithashtu pranë Këshillit të Lartë Gjyqësorë është protokolluar me nr. 459/1 date 23.02.2024 dhe shkresa “kthim e përgjigje”, e Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, nga përmbajtja e secilës rezulton se ankesa e mësipërme është arkivuar me vendimin nr. 1659/5 datë 27.12.2023 të ILD-së.

Sa më sipër, në lidhje me këtë tregues nuk rezultojnë të dhëna, për cenimin e etikës në punë të gjyqtarit subjekt vlerësimi.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit i ka vlerësuar shumë të larta aftësitë e tij në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se Gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se Gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të Gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, etika e Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

3.B Integriteti i Gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, rezulton të jetë regjistruar pranë ILD ankesat si me poshtë për të cilat pas verifikimit, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar, për shkaqet e referuar në analizën e sipercituar tek treguesi 3.A.a “*Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion*”.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 1948/2 prot., datë 10.07.2023, rezulton se:

- a) *Deklaratat e interesave Periodike/Vjetore 2020-2022, janë dorëzuar brenda afateve ligjore.*
- b) *Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit;*
- c) *Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

Lidhur me këtë tregues, edhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “*Gjyqtari {...} ka respektuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës së tij, siç janë shmangja e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti ; aftësia për t’iu përgjigjur pritshmërive të publikut. Ai ka shfaqur vlerat e ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja e tij në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut. Ka treguar paanësi dhe integritet në vendimmarrje. Nuk ka shfaqur paragjykime dhe nuk ka favorizuar, palët ose avokatët, në çështjet përpara gjykatës.*

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të Gjyqtarit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të Gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të Gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të Gjyqtarit, vlerësoj se Gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë

tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të Gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e Gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga Gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i Gjyqtarit.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e Gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se Gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se Gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2020–31.12.2022:

- Për vitin 2020, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i vlerësimit nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë.

- Për vitin 2021, është paraqitur 1 (një) kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, për të cilën është vendosur “Pranuar”. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 1 (një) kërkesë për heqje dorë, e cila është pranuar.
- Për vitin 2022, është paraqitur 1 (një) kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, për të cilën është vendosur “Pranuar”. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 1 (një) kërkesë për heqje dorë, e cila është pranuar.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Kërkesa të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarëve”, të pakonsiderueshëm (nga dy nivelet: tejet i lartë dhe i pakonsiderueshëm). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Numri i kërkesave për përjashtimin tim nga shqyrtimi i çështjeve është i pakonsiderueshëm. Jam përjashtuar vetëm në dy çështje penale. Njëri rast ka ndodhur në çështjen penale të themelit Nuri Meda etj., ku palët kërkuan përjashtimin tim për shkak se kisha gjobitur avokatin e tyre për mosparaqitje pa shkaqe të justifikuara disa herë në seancë, konform nenit 350/4 i K.Pr.Penale. Vlerësoj se kam zbatuar ligjin dhe se vendimmarrja ime ka qenë korrekte. Seanca ishte shtyrë në fazën e konkluzioneve, me qëllim për t’u dhënë mundësi për t’i paraqitur me shkrim. Edhe po të shihet vendim i përjashtimit, në asnjë moment trupi gjykues nuk shprehet për njëanësi, por humbje të besimit të palëve tek gjyqtari, pa specifikuar se cili është shkak i përjashtimit. Gjithsesi çështja është në gjykim në apel, pasi kundër vendimit me ndryshimet e reja, bëhet ankim bashkë me vendimin përfundimtar. Ndërsa rasti i dytë ka ndodhur në çështjen penale të gjyqimit në seancë paraprake Ilir Lika etj. Pasi rrëzova kërkesën e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit, palët kërkuan përjashtimin tim. Gjyqtari që shqyrtoi kërkesën, vendosi përjashtimin e tij, por jo për çështje njëanshmërie, por për çështje të kompetencës funksionale. Sipas tij çështja duhet të shqyrtohej nga gjyqtari i hetimeve paraprake dhe jo nga gjyqtari i seancës paraprake, pasi ishte paraqitur kërkesë për gjykim të drejtpërdrejtë. Gjithsesi në vlerësimin tim çështja e kompetencës nuk mund të zgjidhet nga gjyqtari i së njëjtës gjykatë, por nga Gjykata e Lartë, konform nenit 69 e vijues të K.Pr.Penale. Sqaroj se para vënies në lëvizje të dosjes paraqita kërkesë për dorëheqje, me arsyetimin se duhet të shqyrtohej nga gjyqtari i seancës paraprake.”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit {...} është i pakonsiderueshëm.”

KONKLUZIONI

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e Gjyqtarit (vetëm 4 kërkesa për një periudhë 3 vjeçare), vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i Gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se Gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, marrjen e provave nga të tretët, etj.) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se Gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se Gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga Gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit lidhur me këtë tregues, vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të Gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se Gjyqtari ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së Gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e Gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e Gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se Gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë pjesëmarrësit.

Referuar shkresës me nr. 301/14 Prot datë 5.05.2023 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se: Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, Gjyqtari {...} ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit në aktivitetet trajnuese si vijon:

1. Në aktivitetin e datës 31 janar 2020 me temë: “Menaxhimi i kohës – mjetet e CEPEJ për gjyqësorin”. (Prezent gjatë të gjithë ditës së trajnimit).
2. Në aktivitetin e datave 2 – 3 mars 2020 me temë: “E drejtë për jetë private të qetë me fokus të drejtat e personalitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kufizimet e saj sipas nenit 9/2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.” (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).

3. Në aktivitetin e datave 4 – 5 mars 2020 me temë: *“Çasti i kalimit të pronësisë në kontratat që kanë për objekt tjetërsimin e pasurisë (Përcaktimi i çastit të kalimit të pronësisë. Çasti i kalimit të pronësisë në kontratën e shitjes, kontratën e furnizimit, kontratën e dhurimit, kontratën e sipërmarrjes).” (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).*
4. Në aktivitetin e datës 18 maj 2020 me temë: *“Provat me shkresë në procesin civil dhe autonomia private e palëve në procesin e të provuarit. Përdorshmëria e akteve procedurale dhe papërdorshmëria e provave në gjykimin civil dhe administrativ. Procesi i të provuarit në procesin civil.” (Prezent gjatë të gjithë ditës së trajnimit).*
5. Në aktivitetin e datës 22 maj 2020 me temë: *“Veprat penale në fushën e korrupsionit, sipas ligjit penal dhe normave ndërkombëtare. Problemet teorike dhe të praktikës gjyqësore.” (Prezent gjatë të gjithë ditës së trajnimit).*
6. Në aktivitetin e datës 29 maj 2020 me temë: *“Pavlefshmëria e akteve të procedurës penale. Probleme të praktikës gjyqësore.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
7. Në aktivitetin e datës 6 nëntor 2020 me temë: *“Parimi non reformation in peius në gjykimet rishikuese penale, civile dhe administrative.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
8. Në aktivitetin e datës 29 janar 2021 me temë: *“Ndryshimi i cilësimit juridik të akuzës në gjykimin në seancë paraprakë. Rastet e nevojës për plotësimin e hetimeve paraprake dhe specifikat e kësaj vendimmarrje të GJSSP. Rastet e praktikës gjyqësore të pushimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata e nivelit më të lartë. Problematikat e konstatuara në këtë drejtim.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
9. Në aktivitetin e datave 25- 26 mars 2021 me temë: *“Veprimet paraprake të gjyqtarit dhe vendimet e tij gjatë veprimeve paraprake. Veprimet paraprake, vendimet që merr gjyqtari në këtë fazë; veprimet përgatitore, veprimet proceduralë që kryhen në këtë fazë nga gjykata dhe vendimmarrja e saj; deklarata e mbrojtjes, rëndësia e saj për procesin, mënyra e administrimit dhe lejimit të provës së depozituar me deklaratën e mbrojtjes, afati i paraqitjes, koha, momenti përfundimtar i paraqitjes së provave si nga i padituri ashtu edhe nga paditësi, vendimmarrja për kundërpadinë dhe ndërhyrjen kryesore pas seancës përgatitore.” (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).*
10. Në aktivitetin e datës 16 prill 2021 me temë: *“Trajnime mbi pronësinë intelektuale dhe të drejtat e autorit.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
11. Në aktivitetin e datës 27 prill 2021 me temë: *“Kufijtë e veprimtarisë/kompetencat e gjyqtarit të hetimit paraprak, gjyqtarit të seancës paraprake dhe të gjyqtarit të themelit, në një vështrim krahasues të rolit të secilit sipas dispozitave të reja proceduralë penale. A mundet gjyqtari i themelit të kontrollojë dhe të vlerësojë veprimtarinë e gjyqtarit të seancës paraprake? Raste të problematikave të lindura në praktikën gjyqësore në këtë drejtim dhe nevoja për trajtim, diskutim dhe interpretim të dispozitave të KPP që disiplinonjë veprimtarinë e secilit në procesin penal.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
12. Në aktivitetin e datës 11 maj 2021 me temë: *“Trafikimi i qenieve njerëzore. Risitë në legjislacionin penal. Mbështetja e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
13. Në aktivitetin e datës 2 qershor 2021 me temë: *“Kriteret ligjore dhe procedura specifike e aplikimit të “Lirimit me kusht” të të miturit në konflikt me ligjin. Dallimet në zbatimin e institutit të “Lirimit me kusht” ndaj të dënuarit madhor dhe të miturit në konflikt me ligjin. Zëvendësimi i pjesës së pakryer të dënimit si një risi në legjislacionin penal të drejtësisë për të mitur. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të*

përjetshëm. Standaratet e GJEDNJ-së. Aspekti krahasimor me vendet e tjera.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).

14. Në aktivitetin e datave 11 – 12 tetor 2021 me temë: *“Kudri ligjor për pronësinë intelektuale dhe raste praktike. -Legjislacioni i zbatimit të të drejtave të PI dhe praktika gjyqësore në BE dhe Francë. -Direktiva e Zbatimit 2004/48 dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; - Shterimi në Pronësinë Intelektuale; - Praktika gjyqësore e GJED për të drejtat themelore/e drejta e shprehjes dhe e drejta e pronësisë intelektuale; - nocioni i origjinalitetit sipas praktikës gjyqësore të GJED; - Reforma në BE për markat tregtare; - Direktiva Digjitale 2019/790.” (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).*
15. Në aktivitetin e datës 31 janar 2022 me temë: *“Vlerësimi etiko profesional i gjyqtarëve. Procedimi i vlerësimit të parë në këndvështrimin e legjislatorit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Procedimi i vlerësimit sipas Rekomandimit CM.Rec (2010) 12 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për gjykatësit; pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë. (Miratuar nga Komitetit i Ministrave më 17 nëntor 2010 në mbledhjen e 1098-të të Deputetëve të Ministrave) si dhe Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve European. Skema e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve sipas parashikimeve të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar dhe akteve nënligjore, pjesë e skemës së vlerësimit. Qëllimi i vlerësimit, parimet, burimet, procedura, kriteret e vlerësimit dhe treguesit përkatës.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
16. Në aktivitetin e datës 1 shkurt 2022 me temë: *“Pastrimi i parave.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
17. Në aktivitetin e datës 2 shkurt 2022 me temë: *“ToT: Çështje metodologjike të trajnimit vazhdues të magjistratëve. Nevoja për përmbushje të standarteve ndërkombëtare dhe unifikim të metodologjisë e mjeteve didaktike. Roli i sondazheve të kënaqësisë së publikut. – Manuali për kryerjen e sondazheve të kënaqësisë që synojnë përdoruesit e gjykatave në vendet anëtare të Këshillit të Evropës.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
18. Në aktivitetin e datës 21 shkurt 2022 me temë: *“Kuptimi juridiko-penal në funksion të zbatimit të drejtë të dispozitave të K. Penal, në të cilat parashikohen figurat e veprave penale të mashtrimit. Trajtimi doktrinar i këtyre veprave, bazuar kryesisht në praktikën gjyqësore para dhe pas ndryshimeve të vitit 2017 të kuptimit të përgjithshëm të veprës penale të mashtrimit.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
19. Në aktivitetin e datës 25 shkurt 2022 me temë: *“Risitë e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë. Ridimensionimi i gjykimit në dhomë këshillimi. Veprimet përgatitore të gjykatës. Gjyqtari relator dhe trupa. Procedura e gjykimit dhe vendimmarrja.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*
20. Në aktivitetin e datave 7 – 8 prill 2022 me temë: *“Pastrimi i parave (sipas kurrikulës së përgatitur).” (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).*
21. Në aktivitetin e datave 11 -12 maj 2022 me temë: *“Disponimet testamentare të pavlefshme. Rrethi dhe kufijtë e shqyrtimit të padisë midis gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative lidhur me detyrimin e noterit publik, që të vlerësojë kryesisht rezervën ligjore në momentin e çeljes së trashëgimisë testamentare.” (Prezent vetëm në ditën e parë të aktivitetit trajnues).*
22. Në aktivitetin e datës 16 maj 2022 me temë: *“Përgjimet procedurale dhe përgjimet parandaluese. Trajtimi procedural i të parave dhe vlera e informacionit që përfitohet nga të dytat në procesin penal.” (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).*

23. Në aktivitetin e datave 30 -31 maj 2022 me temë: *“Procedurat për prokurimin publik.”* (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).
24. Në aktivitetin e datave 13 -14 qershor 2022 me temë: *“Standardet ndërkombëtare të punës (SNP) dhe përdorimi i tyre në praktikën gjyqësore; SNP-të për lirinë e organizimit dhe bisedimet kolektive, barazinë e mundësive dhe trajtimin në punë dhe profesion, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me iniciativën e punëdhënësit, sigurinë dhe shëndetin në punë..”* (Prezent gjatë të dy ditëve të trajnimit).
25. Në aktivitetin e datës 24 tetor 2022 me temë: *“Shkrimi dhe arsyetimi i vendimit gjyqësor. Praktikant më të mira.”* (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).
26. Në aktivitetin e datës 9 nëntor 2022 me temë: *“ToT për zhvillimin e trajnimit të magjistratëve.”* (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).
27. Në aktivitetin e datave 14- 15 nëntor 2022 me temë: *“Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria, si elementë të anës subjektive të figurës së veprës penale. Përgjegjshmëria penale në rastin e turbullimit psikik ose neuropsikik që ul ekuilibrin mendor. Roli dhe rëndësia e ekspertimit mjekësor (psikik ose neuropsikik) në të dy rastet. Doktrinë dhe praktikë gjyqësore – shqiptare dhe e huaj.”* (Prezent vetëm në ditën e parë të aktivitetit trajnues).
28. Në aktivitetin e datës 21 nëntor 2022 me temë: *“Rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, zbatimi i urdhërit, ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës – doktrinë dhe praktikë gjyqësore vendase dhe e huaj.”* (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit).

Gjithashtu për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, gjyqtari ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit në aktivitetin trajnues të datës 20 qershor 2022 me temë:

29. *“Hetimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”.* (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit). *“Referuar formularëve të vlerësimit të plotësuar nga pjesëmarrësit në aktivitetin trajnues është vlerësuar “Shumë mirë” për komponentët si vijon: 1- Njohuri të gjetura mbi temën; 2 – Inkurajues i debatit në auditor; 3- Nxitës i kërkimit rreth temës së trajnuar dhe materiali i përgatitur prej tij u ka shërbyer pjesëmarrësve në punën e tyre të përditshme.”*

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, subjekti i vlerësimit është shprehur se: *“Mendoj se kam përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të përcaktuar në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratëve”, duke përmbushur kriterin e dyfishtë të pjesëmarrjes në 5 ditë të plota trajnime në vit dhe jo më pak se 30 ditë gjatë pesë viteve. Kam marrë pjesë në trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme, si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe organizata të tjera partnere të Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu kam marrë pjesë në trajnime jashtë shtetit, konkretisht në datat 22-24 Mars 2022 në trajnimin e organizuar nga European Laë Academy (ERA), i organizuar në Trier të Gjermanisë me temë “Trafikimin e qenieve njerëzore”.*

Gjyqtari {...} përgjatë periudhës 01.01.2020 -31.12.2022 ka marrë pjesë në 29 (njëzet e nëntë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës (në rolin e pjesëmarrësit dhe një në rolin e lehtësuesit) të konvertuar në numër ditësh: 39 (tridhjetë e nëntë) ditë¹³⁹.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se Gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, gjithsej 29 aktivitete të zhvilluara për 39 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e Gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e Gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se: *Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, Gjyqtari {...} ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuesit në aktivitetin trajnues të datës 20 qershor 2022 me temë: “Hetimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”. (Prezent gjatë gjithë ditës së trajnimit). “Referuar formularëve të vlerësimit të plotësuar nga pjesëmarrësit në aktivitetin trajnues është vlerësuar “Shumë mirë“ për komponentët si vijon: 1- Njohuri të gjetura mbi temën; 2 – Inkurajues i debatit në auditor; 3- Nxitës i kërimit rreth temës së trajnuar dhe materiali i përgatitur prej tij u ka shërbyer pjesëmarrësve në punën e tyre të përditshme.”*

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, gjyqtari ka shpjeguar se: *“Për sa i përket këtij kriteri, me gjithë gatishmërinë time për t`u përfshirë në listën e gjyqtarëve udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, nuk plotësoj kriterin 5 –vjeçar të eksperiencës si magjistrat, prandaj nuk kam aplikuar. Megjithatë gjatë punës sime si magjistrat kam pasur shpesh studentë të ciklit “Bachelor në Drejtësi” dhe “Master Shkencor”, që kanë ndjekur seanca gjyqësore dhe janë njohur me procesin punës së veprimtarisë së magjistratit. Gjithashtu kam marrë pjesë si lehtësues në Shkollën e Magjistraturës në Qershor 2022 në trajnimin njëditor me temë “Hetimi i veprave penale në fushën zgjedhore”.”*

¹³⁹ Nga shqyrtimi në tërësi i shkresës, rezulton se Gjyqtari ka marrë pjesë në 37 ditë si pjesëmarrës, dhe 1 ditë si lehtësues, të cilat konvertohen në 39 ditë pjesëmarrje, pra në total 39 ditë, referuar nenit 55 pika 9 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Në çdo rast, Gjyqtari subjekt vlerësimi rezulton të ketë plotësuar parashikimin në shkronjën “a”, pika 3 e nenit 5 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për Gjyqtarin {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e lehtësuesit, në këto kushte ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që Gjyqtari është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues në aktivitetin trajnues të datës 20 qershor 2022 me temë: “Hetimi i veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”

Disponueshmëria e Gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e Gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” rezulton angazhimi i Gjyqtarit dhe për pasojë, pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e Gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë të dhëna për periudhën e vlerësimit (01.01.2020-31.12.2022) në lidhje me pjesëmarrjen e Gjyqtarit në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se gjyqtari {...} ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga organizata të ndryshme si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), me qëllim njohjen me standardet ndërkombëtare të punës dhe problematikat e punëmarrësve. Gjithashru ka marrë pjesë dhe në një trajnim të organizuar me datë 22-24 Mars 2022

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar: “Gjyqtari {...} ka treguar gadishmëri dhe ka marrë pjesë në trajnime të organizuara edhe nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.”

Referuar Metodologjisë gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me

Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstytucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarit për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Në këtë kuadër, vetëm pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet e mësipërme, nuk përbën veprimtari ndërinstytucionale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për Gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e Gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, gjyqtari është shprehur se: “Jam përfshirë në veprimtari, që kanë të bëjnë me publikime shkencore. Në vitin 2019 kam publikuar si bashkëautor i artikullit “Bëgatimi pa shkak në të drejtën administrative”, botuar në Revistën “Jeta Juridike”, nr. 2/2019, botim i “Shkollës së magistraturës”, ISSN 2219-4134.”

Në kushtet kur ky publikim është bërë jashtë periudhës së vlerësimit konkretisht viti 2019 nuk mund të përbëjë burim vlerësimi për gjyqtarin për periudhën 2020-2022.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të Gjyqtarit, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të Gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të Gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	391	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuar në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandoj që Gjyqtari {...} të

mbajë në konsideratë pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2020 - 31 DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga Gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga Gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga Gjyqtari	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit:	

		2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga Gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga Gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë

ngarkesën në punë		3. Mendimi përfundimtar i kryetarit			31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e

					çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej stand{...} : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin

					procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e Gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e Gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë

					Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së Gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e Gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e Gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i Gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të Gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI			
C. Paanësia e Gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga Gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e Gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e Gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga Gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga Gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e Gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e Gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e Gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga Gjyqtari	5-120 ditë	20	Pjesëmarrja e Gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e Gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e Gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e Gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i Gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e Gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

		profesionale të Gjyqtarit			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e Gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			SHKËLQYESHËM		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			391		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR